



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada- Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja- Ministry of Economic Development

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS SË NDËRMARRJEVE PUBLIKE 2014



**NJËSIA PËR POLITIKA DHE MONITORIM TË
NDËRMARRJEVE PUBLIKE**

Përmbajtja

1.	Shqyrtime Hyrëse.....	6
2.	Objektivat dhe Kuadri Rregullativ i Pronësisë së Ndërmarrjeve Publike.....	8
3.	Zhvillimi i Qeverisjes Korporative të Ndërmarrjeve Publike dhe Monitorimi i NP-ve.....	8
3.1	Kuadri Ligjor	11
3.2	Politikat e Pronësisë të Ndërmarrjeve Publike	11
3.2.1	Objektivat e Korporatës dhe Aktivitetet e Biznesit	11
3.2.2	Mbledhjet Vjetore.....	12
3.2.3	Struktura e Kapitalit	12
3.2.4	Performanca e Ndërmarrjeve sipas sektorëve.....	14
1.	Performanca Financare	14
2.	Performanca Operative e NP-ve sipas Sektorëve	15
•	Spektori i Energjisë.....	15
•	Pasqyra e Tregut të Sektorit të Telekomunikimit	16
•	Spektori i Ujit.....	16
•	Numri i Punëtorëve të NP-ve	19
3.2.5	Dividenta	20
3.2.6	Subvencione Shtetërore	20
3.2.7	Përfshirja e Sektorit Privat	23
3.3	Auditimi i Jashtëm.....	23
4.	Performanca Operative dhe Financiare e Ndërmarrjeve Publike	27
4.1	KEK, sh.a	27
4.2	KOSTT, sh.a.....	28
4.3	PTK,sh.a.....	29
4.4	Posta e Kosovës, sh.a	31
4.5	ANP"Adem Jashari"-Kontrolli ajror, sh.a	32
4.6	Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës "TRAINKOS",sh.a.....	33
4.7	Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës "INFRAKOS",sh.a.....	34
4.8	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "Prishtina",sh.a.....	35
4.9	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "HIDROREGJIONI JUGOR",sh.a	36
4.10	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "HIDROMORAVA",sh.a	37
4.11	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "Mitrovica",sh.a	39

4.12	Ndërmarrja Hidroekonomike “IBER – LEPENCI”,sh.a	40
4.13	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit “HIDRODRINI”,sh.a	42
4.14	Kompania Rajonale e Ujësjetlësit “RADONIQI”, sh.a	43
4.15	Kompania e Ujitjes “RADONIQI – DUKAGJIN”, sh.a.....	44
4.16	Kompania e Ujitjes “DRINI I BARDHË”,sh.a.....	45
4.17	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, sh.a	47
5.	Përmbledhje dhe Rekomandime	48

TABELAT

Tabela 1: Performanca Financiare e NP-ve.....	14
Tabela 2: Performanca Operative e Sektorit	15
Tabela 3: Performanca Operative e Sektorit të Telekomunikacionit - PTK	16
Tabela 4: Performanca Operative e Sektorit të Ujit	17
Tabela 5: Numri i Punëtorëve të NP-së	19
Tabela 6: Financimet e Qeverisë për Ndërmarrjet Publike	20
Tabela 7: Projektet e Financuara nga Qeveria sipas Ndërmarrjeve Publike në vitin 2014	22
Tabela 8: Opinonet e Auditorit të Jashtëm në Pasqyrat Financiare 2014	24
Tabela 9: Bonuset dhe Kompensimet e Bordeve të Drejtorëve 2014	25
Tabela 10: Performanca Operative e KEK-ut	27
Tabela 11: Performanca Financiare e KEK-ut.....	27
Tabela 12: Performanca Operative e KOSTT.....	28
Tabela 13: Performanca Financiare e KOSTT-it	28
Tabela 14: Performanca Operative e PTK-së	29
Tabela 15: Performanca Financiare e PTK-së	29
Tabela 16-16a: Performanca Operative- financiare e PK-së.....	31
Tabela 17: Performanca Financiare e ANP "Adem Jashari"	32
Tabela 18: Performanca Operative e TrainKos-it	33
Tabela 19: Performanca Financiare e TrainKos-it.....	33
Tabela 20: Performanca Financiare e InfraKos-it	34
Tabela 21: Performanca Operative e KRU Prishtina	35
Tabela 22: Performanca Financiare e KRU "Prishtina"	35
Tabela 23: Performanca Operative e KRU "Hidroregjioni Jugor"	36
Tabela 24: Performanca Financiare e KRU "Hidroregjioni Jugor"	37
Tabela 25: Performanca Operative e KRU "Hidromorava"	37
Tabela 26: Performanca Financiare e KRU "Hidromorava"	38
Tabela 27: Performanca Operative e KRU "Mitrovica"	39
Tabela 28: Performanca Financiare e KRU "Mitrovica"	40
Tabela 29: Performanca Operative e NH "Ibër - Lepenc"	40
Tabela 30: Performanca Financiare e NH "Ibër-Lepenc"	41
Tabela 31: Performanca Operative e KRU "Hidrodrini"	42
Tabela 32: Performanca Financiare e KRU "Hidrodrini"	42
Tabela 33: Performanca Operative e KRU "Radoniqi"	43
Tabela 34: Performanca Operative e KUR "Radoniqi"	44
Tabela 35: Performanca Operative dhe Financiare	44
Tabela 36: Performanca Financiare e KU "Radoniqi - Dukagjini"	45
Tabela 37: Performanca Operative e KU "Drini i Bardhë"	45
Tabela 38: Performanca Financiare e KU "Drini i Bardhë"	46
Tabela 39: Performanca Operative e KMDK-së	47
Tabela 40: Performanca Financiare e KMDK-së	47

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

AB	Auditori i Brendshëm
AJ	Auditori i Jashtëm
AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës – Kulla Ajrore
ARKEP	Autoriteti Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare
BD	Bordi i Drejtorëve
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrikë
HK	Hekurudhat e Kosovës
HS	Hidro Sistemi (Ibër-Lepenc)
IPTV	Internet Protocol Television, ofrim i shërbimeve të telefonisë, internetit dhe televizionit përmes protokollit të internetit
KA	Komisioni i Auditimit
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës
KKDFE	Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim të Energjisë
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
KRU	Kompania Regjionale e Ujësllësit
KRU Pr	Kompania Regjionale e Ujësllësit “Prishtina”
KRU HRJ	Kompania Regjionale e Ujësllësit “Hidroregjioni Jugor”
KRU HD	Kompania Regjionale e Ujësllësit “HidroDrini”
KRU HM	Kompania Regjionale e Ujësllësit “Hidromorava”
KRU Rd	Kompania Regjionale e Ujësllësit “Radoniqi”
KRU MT	Kompania Regjionale e Ujësllësit Mitrovica
KU	Kompania e Ujitjes
LNP	Ligji mbi Ndërmarrjet Publike
MF	Ministria e Financave
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NP	Ndërmarrje Publike
NJB	Njësi Biznesi
NJPMNP	Njësia për Politika dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike
NJO	Njësia Operative
OST (KOSTT)	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
OECD	Organizata për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik
PB	Plani i Biznesit

PK	Posta e Kosovës
PF	Pasqyrat Financiare
PPP	Partneriteti Publiko-Privat
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
TiK	Telekomi i Kosovës
UD	Ushtrues Detyre
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ZRrUK	Zyra e Rregullatorit për Ujësjetës dhe Kanalizim
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZP	Zyra Postare

1. Shqyrtime Hyrëse

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), sikurse në vitet paraprake, paraqet për shqyrtim para Kuvendit të Republikës së Kosovës propozim Raportin mbi Performancën e Ndërmarrjeve Publike Qendrore për vitin 2014, i cili shqyrtohet paraprakisht edhe në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, kërkohet që të raportohet në baza vjetore në Kuvendin e Republikës së Kosovës për performancën e Ndërmarrjeve Publike (NP).

Me qëllim të pasqyrimin me të saktë të performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2014, ky raport përmban edhe të dhënat krahasuese ndërmjet vitit 2012, 2013 dhe atij 2014. Sa i përket Raportit mbi performancën e NP-ve për vitin 2013, dihet se është hartuar dhe miratuar në Komisionin e Ministrave për Ndërmarrje Publike, mirëpo për shkak të ngërçit politik nuk ka mundur të raportohet gjatë vitit 2014 në Kuvend. Megjithatë, në këtë raport janë përfshirë edhe indikatorët operativ dhe financiar edhe për vitin 2013 me qëllim krahasimi, duke përmbledh rezultatet operative dhe financiare të Ndërmarrjeve Publike dhe duke i analizuar ato rezultate në krahasim me vitet paraprake.

Në kuadër të MZHE-së funksionon edhe Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, e cila ka përgjegjësi ligjore të monitorojë dhe raportoj për performancën e Ndërmarrjeve Publike në mënyrë individuale dhe kolektive.

Andaj mbi këtë bazë, kjo Njësi ka përgatitur këtë raport i cili fokusohet në:

- Performancën operative (rezultatet e arritura, efikasitetin dhe kualitetin e shërbimeve);
- Performancën financiare (qarkullimin e arritur, efikasitetin e shpenzimeve dhe profitabilitetin);
- Qeverisjen korporative (monitorimet e punës së Bordeve, llogaridhënien dhe planifikimin e biznesit);
- Përmbledhjen e raportit dhe Rekomandimet për përmirësimin e qeverisjes korporative dhe performancës së shërbimeve publike.

Gjithashtu, ky raport paraqet Objektivat dhe Projektet për vitin 2015 dhe bën rekomandime për ndryshim të politikave dhe veprimeve të tjera të kërkuara për të përmirësuar performancën e NP-ve.

Raporti është hartuar në maj të vitit 2015, atëherë kur afati ligjor për auditimin e Pasqyrave financiare të NP-ve është përmbushur më 31 maj 2015, por ky raport ndërthen edhe të dhënat operative nga raportet e rregullatorëve të pavarur si të dhëna kredibile.

Raporti është përpiluar për të paraqitur një pikëpamje të qartë të performancës dhe perspektivës në sektorin e Ndërmarrjeve Publike dhe për të paraqitur para deputetëve dhe publikut çështjet

me të cilat përballet niveli i tanishëm i shërbimeve, si dhe zhvillimet që pasojnë për të përmirësuar qeverisjen korporative në këtë sektor.

Raporti nuk përfshinë çështjet teknike të cilat i përkasin vetëm një Ndërmarrjet Publike individuale, sepse këto çështje apo informata mund të nxjerrën në mënyrë me të hollësishme nga Raporti Vjetor i bërë nga vet Ndërmarrja Publike përkatëse (raportet vjetore për secilën NP-ë të veçantë mund të gjenden edhe në faqen e tyre zyrtare të internetit).

Ky raport e paraqet performancën e sektorit të Ndërmarrjeve Publike nga perspektiva e aksionarëve.

Mund të thuhet se, gjatë vitit 2014 kishte një progres në krahasim me vitin paraprak, ndonëse jo ai i prituri nga aksionari. Nga shtatëmbëdhjetë (17) NP-të, në vitin 2014 afarizmin e tyre me bilanc pozitiv-fitim e kanë arritur dhjetë (10) NP-ë, ndërsa shtatë (7) NP-të tjera edhe me tutje fatkeqësisht e kanë përmbyllur vitin me humbje financiare.

Duke shpresuar në një konsolidim dhe bashkëveprim të tërësishëm ndërmjet Qeverisë, NP-ve, por edhe qytetarëve, në të ardhmen mund të pritjet ngritje të nivelit të shërbimeve publike për qytetarët dhe njëkohësisht ngritje të performancës së NP-ve.

2. Objektivat dhe Kuadri Rregullativ i Pronësisë së Ndërmarrjeve Publike

Ndërmarrjet Publike në Kosovë janë në pronësinë e publikut. Në këtë kontekst, Qeveria e Republikës së Kosovës ka kompetencat ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjet Publike Qendrore¹. Qeveria garanton publikun e Republikës së Kosovës që Ndërmarrjet Publike veprojnë në treg në përputhje me parimin e neutralitetit konkurrues, por nga ana tjetër ato fokusohen në përmbushjen e funksionit të tyre të përdorimit të fondeve publike me efikasitet, ekonomi dhe efektivitet, si dhe të maksimizimit të performancës financiare. Publiku, si pronari i vërtetë i Ndërmarrjeve Publike ushtron të drejtat e veta për kontrollin e pasurive të tyre nëpërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe më konkretisht nëpërmjet Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.

Rritja e cilësisë së shërbimeve publike ndaj qytetarëve të Kosovës, rritja e vlerës së aseteve të NP-ve si pasuri e shtetit të Kosovës, renditen në prioritetet strategjike afatgjata të MZHE-së dhe Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.

Si pjesë e detyrave funksionale të monitorimit dhe raportimit të performancës sektoriale dhe individuale të NP-ve është edhe përgatitja e Raportit Vjetor të Ndërmarrjeve Publike Qendrore nga ana e NJPMNP. Raporti Vjetor 2014 i performancës të NP-ve fokusohet në analizën e tre(3) shtyllave kryesore

- Funksionimin e Qeverisjes Korporative;
- Performancën operative sipas sektorëve dhe sipas Ndërmarrjeve Publike Qendrore të sektorëve gjegjësisht me sqarimet e qarta;

3. Zhvillimi i Qeverisjes Korporative të Ndërmarrjeve Publike dhe Monitorimi i NP-ve

Që nga viti 2006, të gjitha Ndërmarrjet Publike janë korporatizuar dhe funksionojnë sipas qeverisjes korporative, të bazuar në parimet e OECD (Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim) të Qeverisjes Korporative.

Sipas këtyre parimeve Ndërmarrjet Publike në Kosovë qeverisen nga një bord efektiv i zgjedhur nga aksionari - Qeveria, bordi i cili është përgjegjës në mënyrë kolektive për suksesin e ndërmarrjes. Në këtë kontekst, Qeveria lejon bordin të ushtrojë përgjegjësitë e veta mbikëqyrëse dhe respekton pavarësinë e tij konform infrastrukturës ligjore duke ia lejuar drejtimin e Ndërmarrjeve Publike, autonomi të plotë operative për të implementuar strategjitë e vendosura nga Bordi i Drejtoreve, si dhe për të arritur objektivat e përcaktuara. Nga ana tjetër, Qeveria nëpërmjet raporteve vjetore sigurohet nëse ndërmarrjet publike kanë kënaqur interesat e të gjithë grupeve të interesit për të arritur një rritje të qëndrueshme, jo në vetëm aspektin financiar, por edhe në aspektin social meqenëse, qëllimi kryesor i Ndërmarrjeve Publike është të veprojnë në

¹ Ndërmarrjet Publike në Kosovë, nga aspekti i pronësisë, ndahen në Ndërmarrje Qendrore me aksionar Qeverinë e Kosovës, në emër të Republikës

së Kosovës dhe Ndërmarrjet Publike Lokale, në pronësinë e komunave. Subjekt i këtij Raporti Vjetor janë Ndërmarrjet Publike Qendrore

interesin më të mirë të përgjithshëm të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Gjatë vitit 2014, me qëllim të plotësimit të përgjegjësive që i përcakton ligji Nr. 03/L-087 dhe Nr. 04/L-111, NJPMNP ka përmbytur detyrat si vijojnë:

- Është monitoruar puna e Bordeve të Drejtorëve përmes shqyrtimit të procesverbaleve të mbledhjeve të Bordeve të Drejtorëve, komiteteve të auditimit dhe komiteteve të tjera. Më konkretisht, gjatë vitit 2014, për shtatëmbëdhjetë (17) Ndërmarrje Publike Qendrore që janë monitoruar nga NJPMNP, janë mbajtur.
 - 17 mbledhje të përgjithshme vjetore me Aksionarin në Qershor të 2014;
 - 203 mbledhje të Bordeve të Drejtorëve;
 - 169 mbledhje të komisioneve të auditimit; dhe
 - 184 mbledhje të komiteteve të përkohshme të bordit

Përgjegjësitë e bordit dhe numri i mbledhjeve të bordit brenda vitit janë të rregulluara me piken 24 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative, sipas së cilit bordi për të kryer përgjegjësitë duhet të takohet rregullisht, por të paktën dymbëdhjetë (12) mbledhje brenda vitit, ndërsa pika 20.5 e Kodit rregullon që tri ditë para çdo mbledhje të bordit, Komisioni i Auditimit do të takohet për të shqyrtuar dokumentet strategjike dhe pikat tjera dhe me pastaj për të i rekomanduar ose jo bordit për miratim. Ndërmarrja Publike Aeroporti i Gjakovës, e themeluar si NP me vendimin e Qeverisë nr.06/180 të datës 28 mars 2014 nuk është funksionalizuar pasi Qeveria akoma nuk ka emëruar Bordin e Drejtorëve

që do të merrte përgjegjësinë, andaj pasi kjo NP-të nuk ka ndonjë operim që krijon të hyra apo shërbime publike nuk kemi se për çfarë të raportojmë. MZHE nga burimet e saja me qëllim të ruajtjes së aseteve ka financuar sigurimin fizik, shërbimet komunale dhe mirëmbajtjen.

- Në cilësinë e vëzhguesit në emër të aksionarit, analistët e NJPMNP kanë marrë pjesë në 61 mbledhje të Bordeve të Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore dhe në (17) shtatëmbëdhjetë mbledhje të Komisionit të Auditimit të NP-ve, gjatë vitit 2014;
- Janë pranuar, përpunuar dhe janë ekzekutuar pagesat për Ndërmarrje Publike Qendrore dhe lokale për realizimin e (29) njëzetë e nëntë projekteve investive të sektorit të hekurudhave, ujit të pijes, ujitjes së tokave bujqësore dhe mbeturinave në vlerë të shpenzuar prej: 5.4 milion euro të financuara nga Buxheti i Shtetit për vitin 2014;
- Janë pranuar, përpunuar dhe janë ekzekutuar pagesat për 32 kërkesa të Ndërmarrjeve Publike Qendrore dhe lokale për subvencionim të:
 - mbulimit të rasteve sociale nga energjia: 1,7 milion euro;
 - blerjes së mazutit për ngrohje: 3.5 milion euro;
 - shërbimeve të ujit dhe mbeturinave për pjesën përtej lbrit: 1.2 milion euro, dhe
 - mbulimit të kostove operative të lëvizjes së trenit të lirë për qytetarët dhe infrastrukturë hekurudhore:

1.1 milion euro apo në tërësi për të gjitha NP-të në vlerë të realizuar prej 7.5 milion euro.

- Janë organizuar dhe përgatitur katër (4) mbledhje të Komisionit të Ministrave për NP-të, në të cilat janë diskutuar shumë çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e NP-ve;
- Me qëllim të ngritjes së transparencës mbi funksionimin e NP-ve është azhurnuar me të dhëna të NP-ve faqja elektronike e MZHE-NJPMNP për NP-të Qendrore duke publikuar për tri vitet e kaluara planet e biznesit, raportet vjetore, raportet e Auditorit të Jashtëm dhe të gjitha dokumentet tjera që i kërkon ligji;
- Janë pranuar dhe përpunuar raporte tremujore dhe vjetore të NP-ve Qendrore;
- Është vlerësuar efektshmëria e punës së Bordeve të Drejtorëve të NP-ve qendrore për vitin 2013 si fryt i bashkëpunimit të NJPMNP dhe kompanisë konsulentë që ka bërë këtë vlerësim. Kompania konsulente dhe e specializuar për vlerësim të efektshmerisë ka bërë vlerësimin në bazë të pikëve nga 1- 5, nga i cili vlerësim me pika 5 dhe 1 e 2, nuk është vlerësuar asnjë bord. Tani është në vijim vlerësimi i efektshmerisë së bordeve për 2014 dhe po presim rezultatet brenda muajit. Anë pse kemi pritur që poentimi të jetë edhe më i varfër, megjithatë kompania që bën vlerësimin është e pavarur në opinionin e vlerësimit gjegjësisht poentimin.
- Është hartuar Raporti Vjetor mbi performancën e NP-ve qendrore për vitin 2013 dhe është shqyrtuar nga Komisioni i ministrave për Ndërmarrje Publike, për shkak të ngërçit politik, nuk është shqyrtuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- Janë përgatitur përgjigjet nga pyetjet e arritura parlamentare dhe të mediave mbi çështjet e NP-ve qendrore;
- Janë kthyer për rishikim dy vendime të Bordeve të Drejtorëve mbi përputhshmërinë e të njëjtave me ligjin, respektivisht Vendimi i bordit të KMDMK mbi miratimin e tarifave për deponimin e mbetjeve shtazore dhe Vendimi i bordit mbi emërimin e KE të InfraKos-it. Gjithashtu, NJPMNP ka komentuar Deklaratat e Politikës së Kompensimit të dërguara nga HK-InfraKos, HK-TrainKos, KRU "Radoniqi", pas miratimit të tyre nga Komisionet e Auditimit të Ndërmarrjeve Publike përkatëse dhe ka dhënë komentet për plotësim;
- Janë dhënë opinione ligjore me kërkesën e MAPL mbi Vendimet e asambleve komunale mbi NP-të Lokale;
- Është prezantuar aktivisht në Komitetet drejtuese të projekteve të donatorëve të sektorit të ujërave të financuara nga qeveria Zvicerane dhe ajo e Luxemburgut;
- Janë trajnuar shtatëmbëdhjetë (17) borde të NP-ve me gjithsejtë 98 pjesëmarrës në trajnim si përmbushje e kërkesës ligjore nga neni 17.6 i ligjit mbi NP-të nga lëmija

e qeverisjes korporatave mbi kryerjen e detyrave fiduciare ndaj aksionarit.

3.1 Kuadri Ligjor

Pas miratimit të Kushtetutës së Kosovës, në Qershor 2008, është miratuar korniza bazë mbi rregullimin pronësor dhe funksionimin e qeverisjes korporative të Ndërmarrjeve Publike Qendrore, siç është: Ligji Nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike. Gjithashtu, është bërë edhe amandamenti i këtij ligji me Nr. 04/L-111, me të cilin është rregulluar auditimi i NP-ve, komunikimi më i mirë i NP-ve me nivelin lokal, themelimi i NP-ve të reja, si dhe plotësimi i listës së Ndërmarrjeve Publike me Ndërmarrje të reja, të cilat më parë ishin nën menaxhimin e AKP-së.

- Me qëllim të mirëfunksionimit të qeverisjes korporative në Ndërmarrjet Publike si mbështetje për implementim sa më efikas të ligjit mbi NP-të, pas miratimit të Politikave Pronësore për Ndërmarrje Publike dhe akteve tjera nënligjore gjatë vitit 2013 dhe 2014 janë hartuar edhe draft-rregulloret relevante për Ndërmarrjet Publike, të tilla si:
 - Hartimi i draft-rregullores mbi emërimin e pjesëmarrësve të Komunave në Bordet e Drejtorëve të ujësjellësve dhe mbi kriteret për krijimin e NP-ve lokale, miratuar në Qeveri gjatë vitit 2013;
 - Hartimi i draft model të Rregullores për Udhëtime Zyrtare të NP-ve e cila pret për miratim nga ministri;

- Hartimi i draft model të Rregullores për Përdorimin e Veturave Zyrtare të NP-ve e cila pret për miratim nga ministri;
- Hartimi i Udhëzuesit-doracakut mbi Auditorët e brendshëm të NP-ve i cili është miratuar dhe dërguar në botim në vitin 2014;
- Plotësim-Ndryshimi i Kodit të Etikës i miratuar dhe dërguar në ribotim në vitin 2014.

3.2 Politikat e Pronësisë të Ndërmarrjeve Publike

Politika e përgjithshme e Qeverisë që i mundëson asaj t'i përcaktojë objektivat e përgjithshme të pronësisë shtetërore, rolin e shtetit në qeverisjen korporatave të Ndërmarrjeve Publike dhe mënyrën se Qeveria do t'i implementojë politikat e saj për pronësinë e ndërmarrjeve përbëhet nga (7) shtatë komponente, si vijojnë:

- Objektivat e korporatës dhe aktivitetet e biznesit;
- Mbledhje vjetore;
- Struktura e kapitalit;
- Performanca e ndërmarrjeve;
- Dividendat;
- Ente të tjera shtetërore;
- Përfshirja e sektorit privat.

3.2.1 Objektivat e Korporatës dhe Aktivitetet e Biznesit

Drejtimi Ekzekutiv është përgjegjës për menaxhimin efektiv të Ndërmarrjeve Publike, i cili përfshinë përgjegjësi

ekzekutive, krijim vlerash, përdorim me efikasitet, ekonomi dhe efektivitet të të hyrave të tyre në të mirën e publikut, vendosjen e objektivave, taktikave operacionale, menaxhimin e rreziqeve dhe kontrolleve dhe matjen e performancës. Ndërsa, Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për të vendosur rregulla dhe standarde që sigurojnë përmbushjen e rolit monitorues të Bordit të Drejtorëve ndaj NP-ve.

Për ta mundur përmbushjen e objektivave të vendosura gjatë vitit 2015 janë hartuar dhe me pas miratuar të gjitha planet e biznesit të NP-ve në afatin ligjor në fund të tetorit të vitit 2014.

3.2.2 Mbledhjet Vjetore

Ashtu siç është parashikuar me nenin 189 të Ligjit mbi shoqëri tregtare, pas finalizimit të raporteve të Auditorit të Jashtëm mbi pasqyrat e konsoliduara financiare në muajin Qershor janë mbajtur mbledhjet e përgjithshme vjetore me Aksionarin me pikat e parapara ligjore të rendit të ditës si: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Auditorit të Jashtëm; Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor të punës, si dhe Shqyrtimi i Performancës së menaxhmentit.

Me autorizimin e Kryesuesit të Komisionit të Ministrave për Ndërmarrje Publike në emër të Aksionarit, NJPMNP gjatë vitit 2014 ka marrë pjesë aktivisht në të gjitha mbledhjet e mbajtura vjetore, duke shtjelluar të dhënat nga raporti në veçanti mbi vlerën e asetëve, gjendjen financiare të NP-ve dhe nivelin e shërbimeve publike, është kërkuar shpjegim dhe sqarime sidomos nga "Ibër- Lepenci", Posta e Kosovës, KEK-u, ujësjellësit e Kosovës dhe kudo që aty ku ka pasur ngecje dhe janë pranuar arsyetimet mbi sfidat e paraqitura para biznesit si janë: mostrajtimi i lendeve në gjykata nga obligimet e pakryera nga konsumatorët, % e ulët e inkasimit nga

konsumatorët dhe mjediset minoritare, mos mbulimi i rasteve sociale për shërbimet e kryera për ujë, mbeturina e ngrohje, shpenzimet e mëdha të zhvlerësimit të IL.

Vlen të theksohet se nga këndvështrimi i NJPMNP, një ndikim jashtëzakonisht të madh negativ në performancën e NP-ve ka pasur edhe stërzgjatja e mandatit të Bordeve të Drejtorëve, të cilat nuk janë treguar plotësisht efektiv në punë duke krijuar një bindje në vetvete sikur se janë të përhershëm dhe shpeshherë kjo ka prodhuar vështirësi në mbikëqyrje e monitorim nga NJPMNP. Kur kësaj i shtojmë edhe faktin se shumë nga bordet kanë përbërje jo komplete, nga të cilat dy borde nuk kanë kuorum për vendimmarrje ("Iber-Lepenci" dhe KRU "Radoniqi"), atëherë kjo sigurisht se ka pasur efektin e vet negativ në performancë dhe qeverisjen korporatave. Sa për dijeni, konkursi për Borde të Drejtorëve të NP-ve qendrore është shpallur tri herë, nga të cilat dy herë është anuluar dhe e fundit nga janari 2015 është në proces.

3.2.3 Struktura e Kapitalit

Struktura e kapitalit të biznesit duhet të jetë adekuate për nevojat e biznesit dhe konsistente me normat ndërkombëtare për industri. Andaj duhet të rishikohet në baza të rregullta nga Qeveria, Bordi i Ndërmarrjes dhe Njësia e NP-ve. Duke pasur parasysh që shumë prej ndërmarrjeve publike kanë hyrë në borxhe për investimin e projekteve, Qeveria duhet të shtojë përpjekjet për mbikëqyrjen e strukturës së kapitalit, me qëllim të sigurimit të likuiditet afatgjatë.

Kur në mënyrë objektive duket e nevojshme, kontributet e reja për kapitalin e aksioneve të Ndërmarrjes do të jenë të mundshme nga Qeveria përmes procesit normal të buxhetit të shtetit, siç ceket në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.

Dhe kështu Aksionari, bazuar në Ligjin mbi ndarjet buxhetore ka shtuar në kapital përmes financimit të aseteve, duke financuar projektet kapitale në shtatëmbëdhjetë (17) Ndërmarrje Publike qendrore e lokale në vlerë të financuar prej 5.4 milion euro.

Do duhej pritur ndryshime dhe ristrukturim edhe nga ANP "Adem Jashari"-Kontrolli ajror, i cili me miratimin e Ligjit mbi Agjencionin e shërbimeve të navigimit ajror, do duhet të ristrukturohej nga një Ndërmarrje Publike, në një Agjencion buxhetor në kuadër të Qeverisë së Kosovës.

3.2.4 Performanca e Ndërmarrjeve

1. Performanca Financiare

Tabela 1: Performanca Financiare e NP-ve

Ndërmarrjet Publike Qendrore	2012			2013			2014		
	Të Hyrat (000€)	Kostot (000€)	Profiti/Humbja (000€)	Të Hyrat (000€)	Kostot (000€)	Profiti/Humbja (000€)	Të Hyrat (000€)	Kostot (000€)	Profiti/Humbja (000€)
ANP "Adem Jashari"	2,593	(4,483)	(1,890)	2,648	(4,423)	(1,775)	2,432	3,471	(1,039)
KEK	269,976	(255,402)	14,574	228,611	(200,771)	27,840	164,353	149,007	15,346
KOSTT	21,524	(18,735)	2,789	24,007	(21,054)	3,557	25,765	(21,393)	4,372
PTK	149,617	(111,279)	38,338	128,891	(92,742)	36,109	100,379	(83,823)	16,556
PK	4,330	(5,499)	(1,169)	10,207	(14,533)	(4,326)	10,045	(14,491)	(4,446)
InfraKos	3,163	(3,215)	(52)	3,467	(3,453)	14	3,629	(3,714)	(85)
TrainKos	5,053	(5,523)	(470)	5,912	(5,189)	723	5,295	(5,165)	130
KRU "Prishtina"	13,514	(13,341)	173	13,784	(13,591)	193	14,165	(13,927)	238
KRU "Hidroregjioni Jugor"	4,069	(4,417)	(348)	4,843	(4,913)	(70)	4,625	(4,623)	2
KRU "Hidromorava"	1,739	(1,772)	(33)	1,945	(1,977)	(32)	2,101	(2,125)	(24)
KRU "Mitrovica"	3,875	(3,329)	546	3,912	(3,379)	533	4,491	(3,267)	1,224
"Ibër-Lepenc"	3,734	(7,904)	(4,170)	4,093	(7,993)	(3,900)	4,184	(8,291)	(4,107)
KRU "Radoniqi"	3,229	(3,787)	(557)	3,734	(4,133)	(399)	3,665	(4,104)	(439)
KRU "Hidrodrini"	3,579	(3,592)	(14)	3,401	(3,411)	(10)	3,796	(3,794)	2
KU "Radoniqi-Dukagjini"	891	(880)	11	690	(689)	1	742	(739)	3
KU "Drini i Bardhë"	266	(3,322)	(34)	309	(295)	14	313	(300)	13
KMDK	1,293	(1,913)	(620)	1,253	(2,003)	(750)	1,459	(2,159)	(700)

Gjatë vitit 2014, sipas tabelës më lart, ka një progres , ndonëse jo ai i prituri nga aksionari. Nga shtatëmbëdhjetë (17) NP-të në vitin 2014, afarizmin e tyre me bilanc pozitiv-fitim e kanë pasur dhjetë NP-të ndërsa shtatë tjera edhe me tutje vitin kanë përmbyll me humbje financiare

Nëse shikohet individualisht, të arriturat janë si në vijim:

- Tri kompani kanë dal me rezultate te arritura pozitive financiare (KOST, KRU “Mitrovica” dhe KRU “Prishtina”);
- Dy kompani kanë arritur të eliminojnë rezultatet negative dhe të dalin në fund të vitit me fitime (KRU “Hidroregjioni Jugor” – Prizren, dhe KRU “Hidrodrini” – Pejë); dhe
- Tri kompani kanë arritur të zvogëlojnë humbjet e tyre nga vitit paraprak (KMDMK, KRU “Hidromorava” – Gjilan dhe ANP);

Nevojitet një performancë më mirë e Postës së Kosovës pasi që ka një trend rritës të humbjeve, ndërsa KMDMK-ja edhe ka arritur të dal me humbje më të vogël në vitin 2014. Një performancë më e mirë do të ishte e mirëseardhur edhe nga kompanitë si: Posta e Kosovës dhe KMDMK, pasi edhe në vitin 2014 janë në humbje financiare.

Arsyet e humbjeve shpjegohen nga kompanitë si vështirësi në afarizëm, jo realizim i padive për konsumatorët e papërgjegjshëm nga ana e gjykatës dhe si rritje e kostove të zhvlerësimit nga asetet e vjetruara ndërsa nga KMDMK si mungesë e inkasimit dhe borgjeve të mëdha që i kanë Kompanitë regjionale të mbeturinave si pronësi e Komunave të Kosovës. Natyrisht se vërehet mungesa e një menaxhimi më të mirë nga menaxhmenti por kjo ndoshta edhe është rrjedhojë e mandatit të stërzgatur të Bordeve të Drejtorëve dhe e mungesës së mbikëqyrjes së duhur ndaj menaxhmentit nga ana e Bordeve të Drejtorëve.

2. Performanca Operative e NP-ve sipas Sektorëve

• Sektori i Energjisë

Dihet se në sektorin e energjisë elektrike rezultatet e angazhimit nuk vërehen menjëherë. Në këtë aspekt kemi rastin që t’i prezantojmë të arriturat e realizuara gjatë kësaj periudhe. Kështu që ky raport ofron një retrospektivë të qartë të punës së kaluar që nxjerrë në pah rezultatet e punës dhe planifikimit përgjatë periudhës së kaluar.

Tabela 2: Performanca Operative e Sektorit

Indikatorët Operativ	Nxjerrja e linjtit në ton (000)	Prodhimi i Energjisë (MWh)	Humbjet në ² Transmisio n (%)
2012	8,028	5,218	1.99
2013	8,219	5,719	2.00
2014	7,204	4,742	2.02

Nga tabela 2 vërehet se sektori i energjetikës për gjenerim energjie ka një zvogëlim në krahasim me vitin paraprak. Pas aksidentit (më 6 qershor) në TC “Kosova A”, njësitë “A4” dhe “A5” nuk kanë operuar në pjesën e mbetur të vitit 2014, ndërsa njësia “A3” ka operuar me performancë mjaftë të mirë, pothuajse pa ndërprerje deri në fund të vitit. Ka qenë e planifikuar që njësitë “A4” dhe “A5” të fillojnë operimin në fund të dhjetorit të vitit 2014. Po ashtu edhe nxjerrja e linjtit ka rënie ngase TC “Kosova A” nuk ka punuar një kohë edhe nevoja për thëngjill ka qenë më e vogël.

- **Pasqyra e Tregut të Sektorit të Telekomunikimit**

Sipas raportit të TM4 të ARKEP për vitin 2014, numri i përdoruesve të telefonisë mobile në Kosovë ka arritur në 1,73 milion apo 95.4% shkallë të penetrimit. Nga këta përdorues, Vala mban 53.4% të tregut sipas përdoruesve, IPKO 36.2% dhe Z mobile 10.4%. Sipas të hyrave, VALA vazhdon të ketë afër 54% të të hyrave në treg.

Sa i përket biznesit të Telekomit, në aspekt të telefonisë fikse, e gjen TiK me 95%³ të hyrave nga zëri.

Numri i linjave të internetit me qasje brez gjerë deri në 2014 i raportuar nga operatorët është 190,802 nga i cili numër, TiK zotëron 17.7% të tregut të përdoruesve dhe 22.71% të hyrave.

Sipas Raportit Vjetor ARKEP 2013, pasi ai i 2014 akoma nuk është publikuar, Tregu i përgjithshëm i telekomunikacionit në Kosovë kap vlerën e 228 milion eurove, pjesën më të madhe të të cilit, apo 75%, e përfshin telefonia mobile, pjesa tjetër mbulohet nga telefonia fikse dhe interneti⁴.

Në Kosovë, PTK me të hyra mbulon 65% të telefonisë mobile, 95% të telefonisë fikse

Tabela 3: Performanca Operative e Sektorit të Telekomunikacionit – PTK

Indikator ët Operativ	Telefonia Fikse (Telekomi) Nr.konsumatorëve	Telefonia Mobile (Vala) Nr.konsumatorëve	Interneti Nr.konsumatorëve
2012	75,634	1,064,860	37,560
2013	69,202	900,000	37,000
2014	72,000	923,820	33,600

³ Sipas Raportit Vjetor ARKEP 2013

⁴ Sipas Raportit Vjetor ARKEP 2013

Nga tabela tre vërehet se ka progres tek telefonia fikse në rritjen e numrit. Të konsumatorëve dhe tek mobile-Vala ndërsa tek interneti, numri i konsumatorëve ka rënë nga viti paraprak .

Kjo rënie mund të ketë ndodhur si pasojë e konkurrencës nga operatorët e tjerë në treg, sidomos atyre privatë e të pa licencuar dhe nga mungesa e investimeve të mjaftueshme ngase kompania ishte në një proces privatizimi ku një pjesë e investimeve me vendim të Qeverisë ishte anuluar.

- **Sektori i Ujit**

Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizim, të ofruar nga kompanitë publike, paraqesin ofruesin kryesorë të këtyre shërbimeve në Kosovë. Aktualisht sipas raportit të ZRRUK në vitin 2014 numri i popullatës së shërbyer nga KRU është rreth 1.476.000 banorë apo është arrit një mbulueshmëri e popullatës me furnizim me ujë të pijshëm prej 84 % që është 2 % me shumë se në vitin paraprak. Gjatë vitit 2014, shkallën më të lartë të mbulueshmërisë me shërbimet e ujit e ka KRU “Radoniqi”-Gjakovë “ 97%, ndërsa shkallën më të ulët të mbulueshmërisë me shërbimet e ujit, gjatë vitit 2014, e ka shënuar KRU “Hidromorava”-Gjilan dhe KRU “Hidroregjioni Jugor” Prizren me nga 61 përkatësisht 65 %, mirëpo krahasuar me vitin 2013, mbulueshmëria nga ana e këtyre dy kompanive ka shënuar rritje prej 4%.

Gjithnjë sipas Raportit Vjetor 2014 të ZRRUK, mbulueshmëria tek ujërat e zeza me shërbimet e kanalizimit gjatë vitit 2014, është në nivelin 63 % . Që në raport me vitin

⁵ Sipas Raportit Vjetor ARKEP 2013

2013 është më e lartë për 3 %. Mbulueshmërinë më të lartë me shërbime të ujërave të zeza në zonën e saj të shërbimit e ka realizuar KRU “Prishtina”, dhe në vitin 2014 ka arritur nivelin me 87 %, duke e rritur mbulueshmërinë e popullatës me këtë shërbim edhe 9 %, në raport me vitin 2013. Në përgjithësi, niveli i mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të zeza në vendin tonë është ende shumë i ulët dhe nevojat për investime në këtë drejtim janë të mëdha. Nivelin me të ulët të mbulueshmërisë me shërbime të mbledhjes së ujërave të zeza ka qenë tek KRU “Hidrodrini”-Pejë me 38 % apo vetëm 1% më shumë se në vitin paraprak, ndërsa nivelin më të lartë KRU “Prishtina” me 87%.

Në vitin 2014 u rrit numri i konsumatorëve të rinj të kyçur në shërbimet e furnizimit me ujë nga KRU për afro 20 mijë sish, si rezultat i zgjerimit të shërbimeve të ujësjellësit nëpër zonat rurale. Gjithashtu, numri i konsumatorëve të cilëve u ofrohen shërbime të ujërave të zeza, është më i lartë se në vitin 2013.

Në nivel të sektorit, mbulimi me ujëmatës për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak është rritur edhe në vitin 2014 dhe ka arritur nivelin në 92%.

KRU “Prishtina” me 97 %, është kompania me proporcionin më të lartë të konsumatorëve me ujëmatës, përderisa KRU “Mitrovica”, ngelet në nivel jo të kënaqshëm, ku vetëm 64 % e konsumatorëve shtëpiakë janë të pajisur me ujëmatës, edhe pse ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2013. Në tabelë janë përfshirë edhe të dhënat nga KRU “Bifurkacioni” Sh.A., për vitin 2014 e cila është nën pronësinë lokale.

Tabela 4: Performanca Operative e Sektorit të Ujit

Indikatorët operativ	2012 ⁶	2013 ⁷	2014 ⁸
Prodhimi i ujit (m³)	134,952	134.000	131,892
Faturimi i ujit (%)	42	43	43
Inkasimi i ujit (%)	70	71	75
Uji i pafaturuar (%)	58	57	57
Testet e dështuara të ujit (%)	1.95	1.25	1.18
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%)	89	91	92
Numri i konsumatorëve	249,265	267,069	286,985

⁶ Të dhënat janë marrë nga Raporti Vjetor 2012- ZRrUK

⁷ Të dhënat janë marrë nga Raporti Vjetor 2013- ZRrUK

⁸ Të dhënat janë marrë nga Raporti Vjetor 2014- ZRrUK

Nga të dhënat e tabelës 4 vërehet se tek sektori i ujit të pijshëm kemi një progres në disa nga treguesit operativ, pasi inkasimi është me i madh 4% nga viti paraprak, ndërsa është rritur numri i konsumatorëve për 19,916 konsumatorë të rinj. Edhe pse ka filluar zbatimi i strategjisë mbi reduktimet e humbjeve të ujit prap kemi një përqindje të njëjtë si në vitin 2013 në 57 %, por pritet të shihen rezultatet më vonë.

Kjo përqindje e dukur e madhe e humbjeve të ujit, e përbërë nga humbjet komerciale dhe teknike, është pothuajse e ngjashme edhe në vendet rajonit të Ballkanit, sado që nuk do të duhej t'i marrim pikë referente krahasuese të njëjtit, por shpresojmë që me konsolidimin dhe fuqizimin e institucioneve përkatëse shtetërore siç janë: inspektoratet, do të zvogëlohet keqpërdorimi i ujit të pijshëm dhe humbjet komerciale, ndërsa me

investime në rrjet nga Qeveria dhe donatorët do të zvogëlohen edhe humbjet teknike.

Mirëpo, duhet të punohet akoma për të arritur një progres më të madh, pasi që në vitin 2014 kishte edhe indikatorë në rënie, siç ishte prodhimi i ujit, apo edhe qëndrimi konstant i përqindjes së humbjes së ujit.

Nëse bëjmë krahasim me vendet e rajonit sa i përket treguesit të matjes së ujit me orëmatës, Kosova me 92 % të matjes së ujit kualifikohet ndër vendet me përqindje të madhe të pajisjes së konsumatorëve me ujëmatës, edhe pse ka mbet edhe shumë për tu bërë tek banesat kolektive të ndërtimit të vjetër.

- Numri i Punëtorëve të NP-ve

Tabela 5: Numri i Punëtorëve të NP-së
Ndërmarrjet Publike Qendrore

	Numri i punëtorëve		
	2012	2013	2014
<i>ANP “Adem Jashari”</i>	151	152	147
<i>KEK</i>	7,630	4,833	4,752
<i>KOSTT</i>	374	368	358
<i>PTK</i>	2,394	2,366	2,332
<i>PK</i>	928	946	988
<i>Infrakos⁹</i>	302	307	331
<i>Trainkos</i>	225	220	224
<i>KMDK</i>	55	65	71
<i>Ibër-Lepenc¹⁰</i>	248	296	289
<i>KU “Drini i Bardhë”</i>	45	44	37
<i>KU “Radoniqi”-Dukagjini</i>	65	61	65
<i>KRU “Prishtina”</i>	539	538	535
<i>KRU “Mitrovica”</i>	226	224	222
<i>KRU “Hidromorava”</i>	152	149	150
<i>KRU “Hidrodrini”</i>	183	216	213
<i>KRU “Radoniqi”</i>	231	240	243
<i>KRU “Hidroregjioni Jugor”</i>	275	291	304
Totali	14,023	11,316	11,261

Nga të dhënat e tabelës pesë mund të konstatojmë se numri total i të punësuarve ka rënie nga 2013 për 55 dhe kjo rënie është paraqitur si rezultat i ristrukturimit të NP-ve gjegjësisht privatizimit të KKDFE(Distribucionit dhe Furnizimit) dhe pensionimit të punëtorëve të NP-ve.

Rritja e të punësuarve tek InfraKos-i është rezultat i implementimit të Planeve të biznesit dhe finalizimit të projekteve të reja kapitale të makinerive dhe mirëmbajtjes së

linjave hekurudhore. Tek kompanitë ku kemi zvogëlim të numrit të të punësuarve ka ardhur si rrjedhojë e pensionimit të një pjese të të punësuarve, sikurse edhe mosvazhdimet të kontratave të punës për shkak të performancës, si bie fjala tek KEK-u.

Sido që të jetë, gjatë pranimit të të punësuarve përmes konkurseve publike janë thirrur dhe inkurajuar për aplikim profesionistët nga gjinia femërore dhe popullata joshumicë, normalisht në përputhje me kërkesat për profesionalitet

⁹ Nr. I punëtorëve është rritur, pasi që kjo kompani punëson punëtorë sezonal

¹⁰ Nr. I punëtorëve është rritur, pasi që kjo kompani punëson punëtorë sezonal

nga kushtet e konkurseve, me qëllim të përmirësimit të strukturës së të punësuarve.

3.2.5 Dividenta

Dividendat janë pjesë e fitimit, e cila shpërndahet nga kompanitë. Duke marrë parasysh këshillat e menaxhimit, Bordi i Drejtoreve, është organi që përcakton se sa mjete nga fitim vjetor duhet të mbeten në Ndërmarrje për ri investime sipas planeve të biznesit të miratuara dhe sa mund të shpërndahen në formën e dividendës.

Gjatë vitit 2014, PTK-ja dhe KOSTT-i kanë qenë dy nga Ndërmarrjet Publike Qendrore që kanë deklaruar dhe kanë shpërndarë dividendë për aksionarin. PTK-ja ka deklaruar dhe paguar 15 milionë euro dividendë dhe KOSTT-i 3.0 milion euro dividendë.

3.2.6 Subvencione Shtetërore

Qeveria për të siguruar vazhdimësi të ofrimit të shërbimeve publike ndanë financim në formë të subvencioneve në ndërmarrje me qëllim të implementimit të politikave zhvillimore qeveritare të ministrive të linjës, në rrethana të caktuara nëse kjo është e përcaktuar me Ligjin për Ndarje Buxhetore. Ja disa shembuj:

Gjatë vitit 2014, bazuar në Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, Qeveria përmes MZHE-së ka

mbështetur me mjete financiare Ndërmarrjet Publike Qendrore e Lokale me buxhet të përgjithshëm prej 12,9 milionë euro, nga të cilat për projekte kapitale 5.4 milion euro ndërsa për implementim të politikave qeveritare subvencione prej 7.5 milion euro.

Më konkretisht,

Qeveria ka subvencionuar Ndërmarrjet Publike, siç janë: KEK-u (raste sociale), TrainKos-i, InfraKos-i, Ndërmarrjet e Ujërave dhe Mbeturinave, si dhe Ngrohjet Qendrore, me një shumë rreth 7.5 milionë euro. Kjo ka qenë një ndihmë financiare e dhënë nga Qeveria me qëllim të mbulimit të rasteve sociale për konsumatorët e energjisë, mbulimit të kostove operative për qarkullimin e trenit të lirë për qytetarët, sigurimit të ngrohjes qendrore, si dhe mbulimit të kostove për shërbime të ujit dhe mbeturinave për pjesën minoritare matanë Ibrit dhe në regjionin e Mitrovicës.

Qeveria, me qëllim të rritjes së mundësisë për sigurimin e shërbimeve më kualitative për qytetarët e saj në saje të zhvillimit të projekteve të reja kapitale, ka investuar 5.4 milionë euro në ndërmarrjet publike si, Hekurudha dhe NP-të Ujërave dhe Mbeturinave. Me investimet në asetet që fitohen përmes implementimit të projekteve të reja rritet vlera e aseteve si pasuri e shtetit të Kosovës.

Tabela 6: Financimet e Qeverisë për Ndërmarrjet Publike

2012	2013	2014
------	------	------

Ndërmarrjet Publike Qendrore dhe Lokale	Investime Kapitale (000)	Subvencione (000)	Investime Kapitale (000)	Subvencione (000)	Investime Kapitale (000)	Subvencione (000)
KEK	0	18.050	0	16,139	0	1,716
KOSTT	2,609	0	0	0	0	0
Infrakos	1,533	0	1,322	750	1,592	600
Trainkos	1,065	500	153	500	0	500
“Ibër-Lepenc”	0	0	0	0	0	0
Ndërmarrjet e Ujërave dhe Hedhurinave	1,917	1,019	3,544	600	3,803	1,249
Ngruhja Qendrore	0	4,400	0	3,500	0	3,500
Gjithsej sipas Kategorive	7,124	23,969	5,019	21,489	5,395	7,565
Gjithsej NP-të Qendrore dhe Lokale	31,093		26,508		12,960	

Tabela 7: Projektet e Financuara nga Qeveria sipas Ndërmarrjeve Publike në vitin 2014

NP	Kodi i projektit	Emri i Projektit	Investimi I realizuar
Infrakos	13605	Makineri për rregullimin e gjeometris së nderruesve dhe binarve	698,552.40
	12898	Renovimi I Urave dhe tunelev ne linjat Hekurudhore	54,977.50
	30217	Furnizimi me pjesë rezerve për infrastrukturën e hekurudhave	107,529.68
	13804	Furnizim me pisje dhe mjte pune për mirmbajtjen e linjave hekurudhore	731,087.00
KRU Prishtina	13939	Rehabilitimi I rrjerit te ujesjellesit në qytetin e Ptitshines - Lagja Ulpiana	100,000.00
KRU Mitrovica	13926	Vendosja e Ujematesve neper zona	92,381.60
KRU Hidroregjioni jugor	13599	Rehabilitimi I rrjetit te ujesjellesit ne rrugen Fetah Gega dhe Kadri Nesho	101,728.56
	13934	Hulumtimi I ujit të pijes të krismat e Mushtishtit dhe Rezervuari V=1000m3	287,016.55
KRU Bifurkacioni	13925	Ujemates me lexim nga distanca, Profil: Fi:1/2 dhe pjes fazonike percjellese	119,999.99
	13929	Nderrim I gypesjellsave primar dhe sekondare - Ferizaj	150,000.00
KRU Radoniqi-DUKAGJIN	13932	Ndertimi I murit mbrojtës me pilota në kanal in Marmull dhe furnizim me pjes nderrimi prej gypa	78,719.43
KRU Hidrodrini	13927	Rehabilitimi dhe zgjerimi I ndertesës së sherbimit teknik	250,000.00
	14098	Ujesjelles per fshatrat e lugut te baranit	429,814.30
	14161	Kanalizim ne qytetin e pejes	41,295.00
	14098	Rrjeti I ujesjellësit Shkoz-junik (Rehabilitimi I tubacionit për ujë të pijëshëm)	27,258.84
KRU Drini I Bardhe	13930	Ndertimi I pendes ne fshatin Dubov-Peje	149,300.95
	13940	Ndertimi I kanalit ne Isnij.	160,000.00
KRU Hidromorava sh.a Gjilan	13931	Ripertritja e rrjetit ekzistues te ujesjellesit; Rr A.Tahiri me rruget ansore - Gjilan	206,757.89
KRU Radoniqi - Gjakove sh.a	13922	linja e ujit te pijes nga bazeni I radoniqit, Faza e II - Linja anadrini	249,999.06
	13935	Kanali derivus I Bazenit të Radoniqit	399,993.87
KRM Pastertia	13973	Blerja e kamionve dy aksor per kontinjer 1.1m3 ne 7 ton	18,000.00
KMDK	13933	Makineri e rende per deponit sanitare	200,000.00
KRM Pastrimi	13928	Kamion special për bartjen e mbeturinave (1.1m3&7m3)	150,000.00
KRM Ekoregjioni	13923	Ndertimi I objektit afarist ne tri njesi te ekoregjionit: Dragashe-Suharej-Rahovec	93,779.25
KRM Qabrati	13924	Paisje për bartjen e mbeturinave	100,000.00
KRM Ambienti	13936	Ndertimi I Halles për linjen klasifikuse ne deponi	62,925.00
KRM Ambienti	13936	Furnizim me kontinjer 1.1m3 per mbeturina 120 litra dhe pjes rezerv për bager	34,000.00
KRM Pastertia	13937	Makineri per bartjen dhe menagjimin e mbeturinave	109,598.68
KRM Uniteti	13938	Automjet transportus speciale per bartjen e mbeturinave - Kompktor	191,164.00
			5,395,879.55

3.2.7 Përfshirja e Sektorit Privat

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 10, Qeveria është përcaktuar për ekonomi të lirë të tregut dhe si rezultat i kësaj inkurajohet përfshirja e sektorit privat në mënyrë aktive në Ndërmarrje Publike. Një përfshirje e tillë do të sigurojë përfitim të përgjithshëm për popullin e Kosovës, duke pasur parasysh:

- Efikasitetin dhe kualitetin e shërbimeve të shpërndara nga ndërmarrja;
- Ndikimin e përgjithshëm ekonomik të strukturave alternative të pronësisë;
- Kapacitetin e buxhetit të Qeverisë për të bërë investime në ndërmarrje që janë të nevojshme për të shpërndarë shërbime në të ardhmen; dhe
- Natyrën e konkurrencës brenda sektorit, në të cilin ndërmarrja operon;
- Baza ligjore për privatizimin e ndërmarrjeve publike dhe futja e kapitalit privat përmes PPP, është e garantuar me nenin 160 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe është e përcaktuar me nenin 9 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin Nr. 03/L-090 mbi Partneritetin Publiko-Privat.

Si rezultat i ristrukturimit të Ndërmarrjeve Publike dhe të implementimit të politikave pronësore ndaj ndërmarrjeve publike shtetërore, me qëllimin të ngritjes së kualitetit të shërbimeve publike ndaj qytetarëve të Kosovës, pas ristrukturimit të

hekurudhave, ANP, KEK dhe PTJ, vazhdon ristrukturimi edhe në vitet e 2013-2014 si vijon:

- **Në vitin 2013-** Komiteti ndërministror i PPP i ka dhënë dritën e gjelbër Njësisë së PPP në kuadër të MF që të rinisë procesin e PPP për Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, ndërsa Komiteti ndërministror i PPP ka autorizuar MMPH si Autoritet Kontraktues të angazhojë Këshilltarë të Transaksionit mbi këtë proces.
- **Në vitin 2014,** është miratuar Ligji mbi Agjencionin e shërbimeve të Navigimit Ajror, sipas së cilës ANP "Adem Jashari", do duhej qysh në korrik të 2014, të transformohej në agjencion qeveritar, por kjo nuk ndodhi edhe me tutje.
- **Në vitin 2014 dhe vazhdon në vitin 2015-** bazuar në strategjinë e energjisë 2009-2108, me ndihmën e konsulencës së USAID-it vazhdon ristrukturimi i KEK-ut në funksion të shthurjes së KEK-ut.

3.3 Auditimi i Jashtëm

Pas përfundimit të çdo viti, të gjitha ndërmarrjet publike i nënshtrohen një Auditimi të Jashtëm nga një Auditor i Jashtëm, i pavarur dhe i kualifikuar. Auditimi i Jashtëm kryhet nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, apo zgjidhet nga ndërmarrja publike me anë të një procesi përzgjedhës në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin për Prokurim Publik. Ky auditor ka për detyrë ta përgatisë një vlerësim sa më real dhe profesional të pasqyrave financiare të ndërmarrjes, si dhe të performancës së saj në çdo aspekt. Raporti i Auditorit të Jashtëm duhet të

paraqitet tek Bordi i Drejtorëve për informim dhe miratim, si dhe të dërgohet tek Njësia për Politika dhe Monitorim të NP-ve ma se largu deri me 30 maj.

Pasi ZAP-i ka konfirmuar se nuk do të bën auditim të rregullsisë së pasqyrave financiare 2014 tek NP-të, ato janë audituar

nga Auditorët e Jashtëm të licencuar si kontraktor të NP-ve.

Tek të gjitha ndërmarrjet ka përfunduar Auditimi i Jashtëm në afatin ligjor për vitin 2014 . Afati ligjor mbi auditimin e pasyrave financiare ishte 30 maj.

Tabela 8: Opinione e Auditorit të Jashtëm në Pasqyrat Financiare 2014

Ndërmarrjet Qendrore	Publike Auditori i Jashtëm	Opinionet e Auditorit të jashtëm në Pasqyrat Financiare në vitin 2014
ANP "Adem Jashari"	Grand Thornton	Kualifikuar me theksim çështje
KEK	Grand Thornton	Pakualifikuar me theksim. çështje
KOSTT	Delloite Kosova	Pakualifikuar
PTK	Grand Thornton	Pakualifikuar
PK	BDO Kosova LL.C	Pakualifikuar
InfraKos	Univezum Audit	Pakualifikuar me theksim çështje
TrainKos	Etika	Pakualifikuar me theksim çështje
KMDK	Alb Audit SH.P.K.	Pakualifikuar me theksim çështje
"Ibër-Lepenc"	Univerzum Audit	Pakualifikuar me theksim çështje
KU "Drini i Bardhë"	Audit Check	Kualifikuar me theksim çështje
KU "Radoniqi-Dukagjini"	Audit&Conto	Kualifikuar me theksim çështje
KRU "Prishtina"	Audit AK	Kualifikuar me theksim çështje
KRU "Mitrovica"	Univerzum Audit	Opinion me rezervë
KRU "Hidromorava"	H&N Sh.p.k	Pakualifikuar me theksim çështje
KRU "Hidrodrini"	Baker Tilly Kosovo	Pakualifikuar me theksim çështje
KRU "Radoniqi"	Audit Chek	Pakualifikuar
KRU "Hidroregjioni Jugor"	Audit&Conto	Pakualifikuar me theksim çështje

Raportet rezultojnë me opinione mbi përputhshmërinë dhe rregullsinë e pasqyrave financiare dhe proceseve të kontrollit të brendshëm me standardet ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe kërkesat ligjore, ku kemi opinionet si më poshtë:

- katër raporte me opinion të pakualifikuar;
- tetë raporte me opinion të pakualifikuar me theksim çështje;
- një raport me opinion të kualifikuar;

- katër raporte me opinion të kualifikuar me theksim çështjeje;
- një raport me opinion rezervë.

Opinionit Rezervë nga Auditori i Jashtëm është dhënë për pasqyrat financiare tek KRU “Mitrovica”, pas auditimit të pasqyrave financiare, pasi sipas Auditorit të Jashtëm pasqyrat financiare të kompanisë edhe pse prezentojnë në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të kompanisë më 31 dhjetor 2014 dhe performancën e saj financiare, ndryshimet në ekuitet dhe rrjedhën e parasë së saj për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2014, në përputhje me standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, rezerva paraqitet pasi shënimet e kompanisë nuk janë përditësuar për të reflektuar daljet e stoqeve gjatë vitit 2014. Në krahasim me vitin paraprak, ky

është një progres simbolik në opinionet e Auditorëve të Jashtëm.

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka Audituar edhe Kompensimet dhe Bonuset e marrura nga Bordet e Drejtorëve në periudhën 2009-2012, dhe nga raporti ka të gjetura dhe rekomandime të theksuara.

Nga të gjeturat, me shqetësueset janë mbipagesat e tërhequra në emër të pagesave të rregullta dhe në emër të bonuseve të disa Borde të Ndërmarrjeve

Publike, por ma të theksuarat janë ato mbipagesa nga raporti i ZAP-it për Bordin e PTK-së, ANP, “Ibër- Lepencit” dhe KRU “Mitrovica”.

Është kërkuar që Bordet e lartë cekura të japin sqarime dhe komente nga të gjeturat e Auditorit, por shumë nga to nuk kanë dhënë sqarime dhe as komente ndërsa Bordi i PTK-së ka theksuar së të gjitha të marrura janë konformë Vendimeve të Bordit, si organ i pavarur Vendimmarrës.

Raporti i Auditorit të Përgjithshëm mbi Kompensimet dhe bonuset e Bordeve 2009-2012, së bashku me një shkresë zyrtare të ministrit të MZHE-së, në tetor 2014, i është dërguar Kryeministrit të Qeverisë së Kosovës si njoftim për aktivitet të mëtejshëm.

Tabela 9: Bonuset dhe Kompensimet e Bordeve të Drejtorëve 2014

Nr.	Ndërmarrja Publike	Bordi	Kom. Auditimit	Komitetet tjera	Bonuset
1	PTK	54,450	3,700	22,830	9,600
2	PK	37,200	6,000	25,270	8,800
3	KEK	55,200	6,000	19,061	7,000
4	KOST	45,075	5,850	12,600	18,597

5	ANP	25,200	4,530	11,040	25,200
6	“Ibër- Lepenc”	10,800	3,240	6,000	12,395
7	InfraKos	15,600	4,800	4,200	9,044
8	TrainKos	19,600	4,464	17,570	9,800
9	KMDMK	14,640	3,840	4,740	8,400
10	KRU “Prishtina”	20,400	4,680	12,435	21,120
11	KRU “Higroregjioni Jugor”	16,800	2,640	9,120	8,400
12	KRU “Hidrodrini”	10,320	2,640	0	0
13	KRU “Radoniqi”	7,080	2,620	2,415	6,331
14	KRU “Mitrovica”	13,560	3,840	12,322	0
15	KRU “Hidromorava”	13,250	5,040	0	0
16	KU “Radoniqi-Dukagjini”	13,560	3,720	2,400	0
17	KU “Drini i Bardhë”	13,250	5,040	0	0
Gjithsej:		385,985	72,644	162,003	144,687

Të dhënat nga tabela e lartpërmendur janë të dërguara nga NP-të, por të pa audituara dhe janë të tërhequra në vitin 2014. Të dhënat për bonuse të tërhequra në vitin 2014 në emër të performancës së afarizmit

2013, ndërsa nëse do të ketë të tilla për performancën e 2014, ato do të mund të tërhiqen vetëm pas Majit 2015 dhe do të raportohen në Raportin Vjetor 2015.

4. Performanca Operative dhe Financiare e Ndërmarrjeve Publike

4.1 KEK, sh.a

Performanca Operative dhe Financiare

Divizioni i Mihjeve kishte për objektiv, si pjesë e planit të Biznesit 2014, nxjerrjen e 8.0 milionë Ton linjit nga të cilat prodhoi vetëm 7.204 Ton apo 90%. Mos realizimi i planit të nxjerrjes të linjtit tek Sibovci Jug-Perëndimor ka ndodh për shkak se Divizioni i Mihjeve ishte i detyruar të punojë me kapacitete të kufizuara për shkak të fatkeqësisë së ndodhur në repartin e elektrolizës në TC “Kosova A”. Përveç kësaj edhe rezervat në mihjet ekzistuese kanë dalë më pak se sa ishin planifikuar dhe ky ishte një shkak tjetër që ka ndikuar mos përmbushje të planit të prodhimit të qymyrit në Divizionin e Mihjeve.

Energji të gjeneruar krahasuar me vitin 2013, viti 2014 ka më pak gjenerim, mirëpo viti bazë i krahasimit (2013) është viti në të cilin është arritur rekord i prodhimit prej lëshimit në punë të këtij termocentrali, ndërsa ngecja e gjenerimit të energjisë vjen edhe si rezultat i pasojave nga avaria-shpërthimi në Termocentralin “Kosova A”. Ndërsa shiquar nga aspekti i caqeve nga plani i biznesit 2014 për gjenerimin e energjisë elektrike, ky cak është arritur vetëm 81%. Në rezultatin e gjenerimit të energjisë kanë ndikuar tre faktor: a) Avaria aksidentale në TC “Kosova A” ku gjatë gjithë vitit kemi pasur në punë vetëm një njësi (A3), b) Projekti i ko-gjenerimit në TC “Kosova B” ka qenë me i gjatë se parashikimi dhe ndaj njësisë (B1) jashtë planit të paraparë, c) Planifikimi i rregullt i remontet gjatë vitit 2014 ka qenë me i gjatë se vitet paraprake.

Tabela 10: Performanca Operative e KEK-ut

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizua2014
Prodhimi i qymyrit në ton (000)	8,028	8,219	8,000	7,204
Prodhimi i energjisë MWh (000)	5,218	5,719	4,832	4,742

Tabela 11: Performanca Financiare e KEK-ut

Indikatorët Financiar (000€)	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat	269,976	230,003	156,845	164,353
Shpenzimet	(212,192)	(159,955)	123,575	(103,476)
Fitimi/Humbja operative	57,784	70,048	33,270	60,877
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(43,210)	(42,208)	40,000	(41,912)
Borxhet e këqija	(13,456)	0	0	(3,619)
Fitimi/Humbja financiare	14,574	26,448	(6,730)	15,346
Paraja në fund të vitit	18,196	26,820	26,000	28,451
Asetet Fikse	366,678	363,529	375,000	350,324

Siç shihet ne tabelë kemi një fitim neto ne krahasim me planifikimet nga plani i biznesit dhe rritje te cash-it nga viti paraprak dhe plani.

4.2 KOSTT, sh.a

Tabela 12: Performanca Operative e KOSTT

Indikatori Oprativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Humbjet ne Transmision ne MWh ne %	1.99	2.00	1.80	2.02

Indikatorët Operativë rreth sasisë për transmision dhe humbjeve në transmision vërehet në tabelën e mësipërme kështu që gjatë vitit 2014 ishte 2.02% nga një MWh.

Performanca Financiare

Tabela 13: Performanca Financiare e KOSTT-it

Indikatorët Financiar (000€)	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat	21,524	24,007	25,879	25,284
Shpenzimet	(9,966)	(11,507)	(11,622)	(11,341)
Fitimi/Humbja operative	11,558	13,104	14,257	14,424
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(8,769)	(9,547)	(10,206)	(10,052)
Borxhet e këqija	0	0	0	0
Fitimi/Humbja financiare	2,789	3,557	4,051	4,372
Paraja në fund të vitit	18,062	21,507	8,992	23,511
Asetet Fikse	114,693	126,871	-	130,538

Të hyrat operative gjatë vitit 2014 janë për 5.1% më të larta në krahasim me vitin paraprak apo për 2.3 me pak se sa planet e të hyrave nga plani i biznesit, ndërsa shpenzimet operative simbolikisht me një vlerë të vogël janë më pak dhe si rezultat kemi një fitim financiar për 19% më të lartë se viti paraprak dhe për 8% më të lartë se sa fitimi i planifikuar në planin e biznesit.

Fitimi para tatimit për vitin 2014 është në vlerë 5,033 milion euro dhe pas tatimit (fitimi neto) 4,372 milion euro.

4.3 PTK,sh.a

Performanca Operative dhe Financiare

Tabela 14: Performanca Operative e PTK-së

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar2014
Nr. i Konsumatorëve (Telekomi)	75,630	69,202	82,286	72,000
Nr. i Konsumatorëve (VALA)	1,064,860	900,000	939,700	923,860
Nr. i Konsumatorëve (Interneti)	37,560	37,000	44,200	33,600

Nga tabela e lartshënuar, vërehet se në relacion me vitin paraprak për nga numri i konsumatorëve kemi progres tek telefonia fikse dhe mobile ndërsa çalon interneti, ndërsa në relacion me caqet nga plani i biznesit kemi ngecje tek telefonia fikse dhe interneti.

Tabela 15: Performanca Financiare e PTK-së

Indikatorët Financiarë (000€)	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat	149,617	130,443	121,407	100,379
Shpenzimet	(90,649)	(77,170)	(69,624)	(66,227)
Fitimi/Humbja operative	58,968	53,273	51,783	34,152
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(20,630)	(17,164)	(17,323)	(16,285)
Borxhet e këqija	0	0	1,807	(1,311)
Fitimi/Humbja financiare	38,338	36,109	32,653	16,556
Paraja në fund të vitit	47,780	54,708	28,756	30,375
Asetet Fikse	99,450	89,827	121,150	103,990

Siç shihet në tabelë, tek asetet kemi ngritje të vlerës e kjo ka ndodhur për arsye të investimeve të reja në asete të reja.

PTK shihet se vitin kalendarik 2014 e ka përfunduar me një fitim operativ prej 34 milion euro që është 19 milion më pak se viti paraprak dhe me fitim financiar përfundimtar prej 16.5 milion euro apo për 24 milion më pak se vitin paraprak 2013. Shiqar në relacion me caqet e parapara nga plani i biznesit kemi rënie të të hyrave për 30 milion euro dhe kemi rënie të fitimit për 50% nga caku i paraparë për vitin 2014.


Në aspekt të performancës, në krahasim me vitin 2013, të hyrat e PTK-së ishin më të ulëta për 24%.

Vlen të përmendet se operimet e Vala-s vazhdojnë të ndikohen negativisht nga përdorimi i aplikacioneve pa pagesë përmes përdorimit të internetit të cilat sollën rënie të hyrave në segmentet e prepaid, postpaid, incoming dhe roaming.

Sa i përket TiK-ut, segmenti i cili ishte më i mirë në krahasim me vitin 2013 ishte ai i IPTV-së dhe internetit, përderisa të hyrat nga zëri, interkoneksioni dhe ato nga bizneset kanë shënuar rënie.

Kontributi i të ardhurave në vitin 2014 në mes të Vala-s dhe TiK-ut ishte në proporcionin 86% me 14% në të mirë të Vala-s.

Në krahasim me vitin 2013, vërehet një rritje graduale e kontributit në të hyra të Vala-s në krahasim me TiK-un, nga 83% në vitin 2013 në 86% në vitin 2014.



4.4 Posta e Kosovës, sh.a

Performanca Operative dhe Financiare

Tabela 16: Performanca Operative e PK-së

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Vëllimi Fizik i Dërgesave në Shkuarje	192,659	207,920	200,000	197,264
Vëllimi Fizik i Dërgesave në Ardhje	346,463	356,632	410,000	409,569

Të dhënat në këtë tabelë paraqesin një raport mbi trendin e vëllimit fizik të dërgesave postare në pranim dhe dërgim. Siç mund të shohim, ky trend është në progres e sipër duke e krahasuar atë me vitin paraprak por shiqur me caqet e parapara në Planin e biznesit pothuaj se i afrohen arritshmerisë së pritshme.

Tabela 16a: Performanca Operative e PK-së

Indikatorët Financiarë (000€)	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat	4,402	10,398	10,471	10,045
Shpenzimet	(4,904)	(12,528)	13,154	(12,362)
Fitimi/Humbja operative	(502)	(2,130)	(2,683)	(2,317)
Zhvlërësimi dhe amortizimi	(667)	(1,785)	(2,145)	(2,129)
Borxhet e këqija	0	0	-	0
Tatimi i shtyrë	0	(411)	-	0
Fitimi/Humbja financiare	(1,169)	(4,326)	(4,858)	(4,446)
Paraja në fund të vitit	7,799	3,792	-	1,017
Asetet Fikse	20,791	20,246	-	18,566

Tabela e mësipërme tregon gjendjen financiare të PK-së gjatë vitit 2013,2014 dhe viti raportues 2014 përmbyllet me një humbje financiare prej 4.4 milionë euro, me asete fikse prej 18.5 milionë euro, që përfshijnë 92% të aseteve të ish- PTK-së dhe që në fund të vitit 2014 në llogari bankare mjete prej 1.0 milionë euro, mjete këto disa nga të cilat ishin të transferuara nga ish-PTK-ja me rastin e ndarjes, me qëllim të implementimit të projekteve kapitale që ishin pjesë e Planit të Biznesit të tërësishëm të PTK-së të parandajës.

Ne nuk do të krahasojmë vitin 2013 me vitin 2012 pasi që viti 2012 mbulon vetëm pjesën katër mujore dhe jo të gjithë vitin ndërsa viti 2014 ishte kryesisht i njëjtë me të hyra dhe kosto dhe rezultojnë me një humbje të njëjtë si të vitit paraprak. Prandaj, mund të themi që gjatë vitit 2014, kemi një humbje prej 4.4 milionë euro.

Nga Raporti i auditorit vërehet se vetëm kostot e pagave mbërrijnë afro 95% të të hyrave gjë që tregon se kjo kompani nuk mund të vazhdon me këtë nivel të kostove të pagave që arrijnë në 800 euro mesatare mujore për punëtorë apo dyfishi i pagës mesatare në sektorin publik.

4.5 ANP "Adem Jashari"-Kontrolli ajror, sh.a

Indikatorët Financiar

Tabela 17: Performanca Financiare e ANP "Adem Jashari"

Indikatorët Financiar (000€)	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat	2,618	2,694	3,708	2,432
Shpenzimet	(3,750)	(3,671)	(3,368)	(2,725)
Fitimi/Humbja operative	(1,132)	(977)	340	(293)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(758)	(797)	(850)	780
Borxhet e këqija	0	0	-	0
Fitimi/Humbja financiare	(1,890)	(1,775)	(510)	(1,039)
Paraja në fund të vitit	1,021	22	15	52
Asetet Fikse	7,938	8,643	7,890	7,890

Gjatë vitit 2014 tek ANP-KA "Adem Jashari" Sh.A. Krahasuar me vitin paraprak kemi një ulje të të hyrave prej 8 % si rrjedhojë e ecurive të tregut aeronautik dhe operimit të operatorit Lion-Limak. Lidhur me shpenzimet ka ulje të shpenzimeve krahasuar me vitin paraprak si rrjedhojë e kursimit maksimal si arsye e gjendjes financiare në të cilën ndodhet kompania. Kompania kishte probleme të mëdha me kompensimin e pronave të parakoncesionimit dhe të arritura për pagesë me vendime gjyqësore, mirëpo Qeveria me Vendim të saj ka rregulluar kompensimin e tyre nga fondi i shpronësimit në MMPH.

4.6 Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës “TRAINKOS”,sh.a

Indikatorët Operativ dhe Financiar

Tabela 18: Performanca Operative e TrainKos-it

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Transporti i Mallrave (ton)	747,416	1,002,457	878,961	837,829
Nr. i udhëtarëve	366,537	369,777	381,198	352,410

Siç mund të shihet në tabelën, gjatë vitit 2014 TrainKos-i ka pasur rënie në transportin e mallrave prej 16.5% në krahasim me vitin 2013, kjo vjen si zvogëlim i kërkesave të tregut, në veçanti me Kompaninë New Co Ferronikeli, por që kjo është diku afër planifikimit nga plani i biznesit.

Sa i përket realizimit financiar në transportin e udhëtarëve nga shitja e biletave kemi pasur një rritje të të hyrat prej 3.02 % më shumë në krahasim me vitin 2013 dhe kjo mospërputhje vie si rezultat i ndërrimit të proporcionit të urdhërave në relacion me konsumatorët e beneficuar si shtresa sociale etj. Dhe ky ndërrim ishte në të mirë të rritjes së udhëtarëve që paguajnë udhëtimin. Përkundër kësaj, shpenzimet e qarkullimit të trenave të udhëtarëve ende mbetën të pambuluara ashtu siç e parasheh Ligji për Hekurudhat dhe për këtë arsye humbjet nga transporti i udhëtarëve për vitin 2014 janë - 476,831.85 € apo - 21 %.

Gjithashtu kemi pothuaj nivel në rënie të numrit të udhëtarëve në krahasim me vitin paraprak 2013 për 4.6 % apo për -17,367 udhëtarë.

Tabela 19: Performanca Financiare e TrainKos-it

Indikatorët Financiar (000€)	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat	5,053	5,912	6,015	5,295
Shpenzimet	(4,803)	(4,334)	5,986	(4,199)
Fitimi/Humbja operative	250	1,578	29	1,095
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(720)	(856)	(874)	(966)
Borxhet e këqija	0	0	/	0
Fitimi/Humbja financiare	(470)	723	(844)	129
Paraja në fund të vitit	458	598	/	1,018

Asetet Fikse	6,962	7,641	/	6,734 ¹¹
---------------------	-------	-------	---	---------------------

Nga tabela e mësipërme shihet se TrainKos-i ka rënie të të hyrave ngase ka rëne numri i udhëtarëve dhe tonazha e transportit të mallrave, megjithatë vërehet se ka zvogëluar edhe kostot dhe TrainKos-i edhe me tutje është në fitim financiar edhe pse më i vogël se ai i vitit paraprak.

4.7 Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës “INFRAKOS”,sh.a

Performanca Financiare

Tabela 20: Performanca Financiare e InfraKos-it

Indikatorët (000€)	Financiar	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat		3,163	3,467	3,035	3,629
Shpenzimet		2,215)	(2,360)	3,022	2,625
Fitimi/Humbja operative		948	1,107	13	1,004
Zhvlerësimi dhe amortizimi		(990)	(1,093)	/	(1,089)
Borxhet e këqija		(10)	0	/	0
Fitimi/Humbja financiare		(52)	14	/	(85)
Paraja në fund të vitit		133	316	/	240
Asetet Fikse		19,804	20,432	/	20,916 ¹²

Nga tabela e mësipërme shihet se kompania fitimin e vitit 2013 e ka kthyer në humbje në vitin 2014 ani se simbolike, dhe kjo si rezultat i rritjes së kostove, ndërsa vërehet se kemi edhe rritje të vlerës së aseteve dhe zvogëlim të keshit në krahasim me vitin paraprak. Plani i Biznesit i miratuar nga Bordi i Drejtorëve nuk i kishte të parapara të gjitha caqet me përjashtim të hyrave të planifikuara dhe Kostove operative të planifikuara, nga të cilat vërehet ka tejkalim të caqeve tek zëri i të hyrave dhe ulje të kostove operative nga ato të planifikuara.

¹¹ Të dhëna sipas Pasqyrave të të ardhurave

¹² Sipas Pasqyrave të të ardhurave të Infracos-it

4.8 Kompania Rajonale e Ujësjetës "Prishtina",sh.a

Performanca Operative dhe Financiare

Tabela 21: Performanca Operative e KRU Prishtina

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl. Bizn. 2014	Realizuar 2014
Prodhimi i Ujit në (000)m3	45,064	41,246	44,465	37,554
Faturimi i Ujit (%)	47	50	52	51
Inkasimi i Ujit (%)	75	76	73	80
Uji i pafaturuar (%)	53	50	48	49
Testet e Dështuara të Ujit (%)	2.2	0	/	0,56
Konsumatorëve me Ujëmatës (%)	96	97	89	97
Numri i Konsumatorëve	106,945	113,294	116,290	107,892

Nga tabela shihen treguesit progresivë në krahasim me vitin paraprak tek: faturimi i ujit, humbjet e ujit dhe tek inkasimi që është krijuar një stabilitet i cili nga viti në vit po forcohet.

Thatësia dhe mungesa e reshjeve gjatë vitit 2014, ka zvogëluar në masë të madhe sasinë e ujit të prodhuar, për 3,691 mijë m3 më pak se në vitin 2013, ndërsa nga pastrimi i regjistrave nga konsumatorët fiktiv shihet se ka rënie të numrit të konsumatorëve.

Testet e dështuara të ujit këtë vit janë përmirësuar dukshëm dhe janë në kuadër të limiteve të lejuara për testet e dështuara të ujit.

Tabela 22: Performanca Financiare e KRU "Prishtina"

Indikatorët Financiar (000€)	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat	13,514	13,784	15,156	14,164
Shpenzimet	(8,055)	(8,120)	(9,103)	(10,437)
Fitimi/Humbja operative	5,459	5,664	6,053	3,965
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(3,574)	(2,869)	(3,057)	(3,727)
Borxhet e këqija	(1,712)	(2,601)	(4,445)	0
Fitimi/Humbja financiare	173	193	(1,449)	238
Paraja në fund të vitit	1,732	3,952	/	3,829
Asetet Fikse	55,984	62,120	/	64,739

Po analizuam nivelin e treguesve kryesor të performancës financiare për vitin 2014, krahasuar me vitin 2013, vërehet se ka përmirësime dhe ndryshime pozitive. Tek asetet fikse, vërehet se kemi një përmirësim apo rritje të vlerë së pasurisë krahasuar me vitin paraprak prej 4.1%, kjo tregon se kompania po i rritë pasuritë e saja duke rritë investimet në asetet e veta.

Rrjedha e parasë (paraja e gatshme), edhe përkundër kryerjes së shumë pagesave dhe shpenzimeve që u krijuan gjatë vitit 2014, është më e vogël për 122 mijë euro. Rezultati financiar, edhe përkundër zhvlerësimit është rezultat financiar pozitiv apo fitim më i lartë se viti paraprak, ky është një tregues i rëndësishëm dhe vlerësohet nga palët e interesit dhe aksionari i kompanisë.

4.9 Kompania Rajonale e Ujësllësit "HIDROREGJIONI JUGOR",sh.a

Performanca Operative dhe Financiare

Tabela 23: Performanca Operative e KRU "Hidroregjioni Jugor"

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Prodhimi i Ujit në (000)m3	19,614	19,274	19,972	17,483
Faturimi i Ujit (%)	39	40	42	41
Inkasimi i Ujit (%)	71	72	76	75
Uji i pafaturuar (%)	61	60	58	59
Testet e Dështuara të Ujit (%)	4.4	2.5	/	3
Konsumatorëve me Ujëmatës (%)	93	96	/	96
Numri i Konsumatorëve	36,226	38,878	41,157	41,157

Kompania në nivel regjional gjatë vitit 2014 ka shtuar aktivitetet kryesore për zvogëlimin e ujit të pafaturuar-humbjes së ujit që nënkupton parandalimin e keqpërdorimeve dhe sanimin me kohë të defekteve. Por edhe pas këtyre angazhimeve nuk ka pasur ndonjë sukses ngase ka vazhduar keqpërdorimi i ujit nga përdoruesit ilegal.

Për vitin 2014 në nivel regjional janë raportuar prodhim të ujit 17,483 milionë m3 krahasuar me vitin 2013 kemi një rënie të prodhimit të ujit të pijes prej: 1,791,000 m3 dhe kjo rënie vërehet edhe në relacion me planin por viti 2014 mbahet mend për dekada si viti më i thartë me zvogëlim të kapaciteteve nga burimet ujore.

Rritja e faturimit për vitin 2014 është si rezultat i rritjes së angazhimit të menaxhmentit në këtë periudhë në krahasim me periudhën paraprake, si dhe marrjes në menaxhim nga Kompania të disa fshatrave të regjionit.

Mbulshmëria e popullatës me furnizim me ujë të pijshëm në vitin 2014 është 65% domethënë ka pas një rritje prej 2% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Edhe numri i konsumatorëve në vitin 2014 është rritur për 2.279 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar që duke marr nën menaxhim zonat rurale të sistemit të furnizimit me ujë, ka kushtëzuar edhe rritjen e numrit të të punësuarve për mirëmbajtje dhe për leximin e orëve dhe inkasimin e të hyrave.

Tabela 24: Performanca Financiare e KRU "Hidroregjioni Jugor"

Indikatorët (000€)	Financiar	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat		4,069	4,843	4,573	4,625
Shpenzimet		(2,770)	(3,017)	3,127	(3,136)
Fitimi/Humbja operative		1,299	1,826	1,446	1,489
Zhvlerësimi dhe amortizimi		(923)	(1,102)	/	(1,201)
Borxhet e këqija		(724)	(795)	/	(286)
Fitimi/Humbja financiare		(348)	(70)	/	2
Paraja në fund të vitit		60	33	/	130
Asetet Fikse		16,467	16,919	/	16,691

Tek shpenzimet kemi një rritje në krahasim me vitin e kaluar për arsye se gjatë vitit 2014 është investuar në hulumtimin e burimeve të reja nëntokësore të ujit, përmes shpimit të puseve në Baqevc investim nga Komuna e Suharekës, që ka ndikuar direkt edhe në rritjen e shpenzimeve, mirëpo zvogëlimi i borxheve të këqija ka ndikuar që viti të mbyllet me fitim financiar prej 2 mijë euro nga humbja e vitit të kaluar.

4.10 Kompania Rajonale e Ujësjellësit "HIDROMORAVA",sh.a

Tabela 25: Performanca Operative e KRU "Hidromorava"

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Prodhimi i Ujit në (000)m3	7,610	7,730	7,685	7,593
Faturimi i Ujit (%)	39	45	47	42
Inkasimi i Ujit (%)	74	70	74	72
Uji i pafaturuar (%)	61	55	53	58
Testet e Dështuara të Ujit (%)	1.1	1	/	1
Konsumatorëve me Ujëmatës (%)	85	85	90	88
Numëri i Konsumatorëve	21,574	23,151	24,430	24,737

Nga tabela shihet se krahasuar me vitin 2013, disa nga indikatorët operativ kanë trend në rënie, si UPF, faturimi i ujit etj. Prodhimi i ujit gjatë vitit 2014 ka qenë në suaza të kërkesave dhe të planifikimit. Janë prodhuar 1.8 % m3 ujë me pak se vitin paraprakë. Por edhe në relacion me planifikimet nga Plani i Biznesit ka trendë rënie

Përkundër furnizimit të mirë të konsumatorëve me ujë të pijes, kompania ende nuk ka arritë që në shkallë të mjaftueshme ta ulë sasinë e ujit të pafaturuar, përkundrazi ka pas një rritje prej 3% në krahasim me vitin e kaluar.

Arsyet që nuk kanë mundësuar një rezultat më të mirë në këtë aspekt janë: mungesa e kapaciteteve të ujit gjatë periudhës së tremujorit të parë të vitit 2014, mos pastrimi i zonave nga parregullsitë, keqpërdorimet, mbulueshmëri e pamjaftueshme e zonave me ujëmatës funksional, mungesa e lexueshmërisë së rregullt të ujëmatësve, rrjeti i amortizuar etj.

Zona e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm nga KRU "Hidromorava" Sh.A., vlerësohet të ketë rreth 172,500 banorë.

Ndërsa inkasimi ka pas një rritje të lehtë prej 2% në krahasim me vitin paraprak.

Gjatë periudhës 2014 kualiteti i ujit ka qenë në nivelin e kënaqshëm duke i plotësuar kërkesat e Institutit të Shëndetit Publik i cili njëherit edhe e bënë kontrollin e ujit të prodhuar nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit. Nga tabela shihet se vetëm 1% e monstrave kanë dështuar nga total i monstrave të analizuara dhe nga kjo mund të themi se kompania ka arritur t'i përmbush standardet e kërkuara për kualitet të ujit të caktuar nga IKSHP.

Numri i konsumatorëve është rritur për 1.586 konsumatorë, në këtë rritje ka ndikuar legalizimi i konsumatorëve ilegal, regjistrimi i konsumatorëve të rinj të banesave kolektive;

Nga treguesit e arritur të performancës për vitin 2014 konkludojm se, kompania "Hidromorava", Sh.A po i konsolidon gjithnjë e më tepër shërbimet dhe afarizmin e vet, dhe gjatë këtij viti ka pasur një përmirësim të dukshëm në performancë por jo edhe aq sa duhet në arritjen e objektivave dhe strategjisë së përcaktuar nga kompania.

Mbulueshmëria e popullatës me furnizim me ujë të pijshëm në vitin 2014 është 65% domethënë është për 2% më e madhe se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Tabela 26: Performanca Financiare e KRU "Hidromorava"

Indikatorët (000€)	Financiar	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat		1,881	1,945	1,918	2,101
Shpenzimet		(1,221)	(964)	1,252	(1,373)
Fitimi/Humbja operative		660	981	666	728
Zhvlerësimi dhe amortizimi		(514)	(440)	(510)	(452)
Borxhet e këqija		(180)	(509)	(150)	(300)
Fitimi/Humbja financiare		(33)	(32)	6	(24)
Paraja në fund të vitit		157	163	/	100
Asetet Fikse		8,783	8,375	/	9,877

Të hyrat nga shitja e ujit gjatë vitit 2013 janë më të larta afërsisht për 7.5% krahasuar me ato të vitit 2013. Kjo rritje e të hyrave ka rrjedhë si rezultat i evitimit të kyqjeve ilegale dhe zgjerimit të zonë se shërbimit, gjegjësisht marrjen në menaxhim të ujësjellësve rural.

4.11 Kompania Rajonale e Ujësjellësit "Mitrovica",sh.a

Indikatorët Operativ dhe Financiar

Tabela 27: Performanca Operative e KRU "Mitrovica"

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Prodhimi i Ujit në (000)m3	17,610	16,899	16,600	19,562
Faturimi i Ujit (%)	48	50	51	41
Inkasimi i Ujit (%)	50	50	54	48
Uji i pafaturuar (%)	52	48	49	59
Testet e Dështuara të Ujit (%)	3	1	1,4	2
Konsumatorëve me Ujëmatës (%)	57	59	62	64
Numri i Konsumatorëve	26,095	26,932	26,980	22,281

Rrjedha e prodhimit të ujit gjatë vitit 2014 ka qenë mjaftë standarde duke plotësuar normat vendore të prodhimit të ujit dhe duke i tejkaluar kapacitet e instaluara teknike. Duhet theksuar se gjatë këtij viti me mbështetjen e projektit të financuar nga Qeveria e Luksemburgut tani bëhet matja digjitale e prodhimit të ujit në disa zona të caktuara të regjionit.

Edhe inkasimi në vitin 2014 është më i ultë për 2% në krahasim me vitin paraprak apo 6% nën planifikimet.

Kjo ulje e inkasimit vjen si rrjedhojë e një mungese të një menaxhimi më të mirë, si pasoj e keqpërdorimit të ujit dhe numër të vogël të konsumatorëve me ujëmatës vetëm 64%, e që përdorin ujin paushall, si dhe një numëri të madh të rasteve sociale në regjion. Ky numër i konsumatorëve me orëmatës është duke u rritur duke iu falënderuar Qeverisë së Kosovës që po investon në orëmatës.

Tek kualiteti i ujit mund të thuhet se është në përputhje me standardet vendore.

Ndërsa numri i konsumatorëve të regjistruar gjatë vitit 2014 është zvogëluar nga se ka filluar çregjistrimi i konsumatorëve fiktiv duke përfshirë këtu edhe konsumatorët pasiv.

Shikuar në tërësi, pikat më të dobëta të operimit janë: niveli shumë i ulët i inkasimit vetëm 48 %, apo për 24% nën mesataren e sektorit që është 72%, si dhe përqindja shumë e ulët e konsumatorëve me ujëmatës.

Mbulushmëria e popullatës me furnizim me ujë të pijshëm në vitin 2014 është 66% d.m.th është për 2% më e madhe se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Tabela 28: Performanca Financiare e KRU "Mitrovica"

Indikatorët (000€)	Financiar	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat		3,875	3,912	3,240	4,491
Shpenzimet		(2,069)	(2,039)	2,000	(1,976)
Fitimi/Humbja operative		1,806	1,873	1,240	2,515
Zhvlerësimi dhe amortizimi		(1,213)	(1,340)	/	(1,291)
Borxhet e këqija		0	0	/	0
Fitimi/Humbja financiare		593	533	/	1,224
Paraja në fund të vitit		32	12	/	55
Asetet Fikse		18,597	19,263	/	17,853

Fitimi financiar për vitin 2014 është 1.2 milionë euro, ky fitim ka ardhur si rezultat i marrjes së subvencioneve nga Qeveria në vlerë prej: 1.0 milionë euro. Kjo pjesë e mjeteve që është ndarë nga Qeveria e Republikës së Kosovës është destinuar për mbulimin e faturave të papaguara nga komuniteti minoritar në pjesën veriore.

4.12 Ndërmarrja Hidroekonomike "IBER – LEPENCI",sh.a

Performanca Operative dhe Financiare

Tabela 29: Performanca Operative e NH "Ibër - Lepenc"

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Uji i Furnizuar (m3)	37,374	33,899	33,540	33,321
Ujitja e Tokave Bujqësore (ha)	1,860	1,703	1,710	1,490
Energjia e Prodhuar dhe Shitur (MWh)	65,784	99,387	86,894	101,517

Pasi që plani është përpiluar sipas kërkesave të shfrytëzuesve, në tabelë shihet së realizimi i distribuimit të ujit është më i ulët për 578 mijë m3 ujë në krahasim me vitin e kaluar, apo për 219 mijë m3 nga plani. Vlen të theksohet se furnizimi me ujë industrial është kryesisht i ndikuar nga kërkesat e klientëve për sasinë e ujit që ju nevojitet.

Edhe ujitja varet kryesisht nga interesimi i fermerëve për ujitje të tokave bujqësore. Gjatë vitit 2014 shihet që realizimi është për 213 ha ma i ulët në krahasim me vitin 2013 apo për 220 ha me

pak se plani. Rënia e hektarëve të ujitur është si rezultat i rënies së kërkesës nga ana e fermerëve për kultivimin e kulturave bujqësore.

Gjenerimi i energjisë elektrike, në periudhën Janar-Dhjetor 2014, është më i lartë se në vitin 2013 për 2,130 MWh energji elektrike apo më shumë për 15% nga plani.

Gjenerimi i energjisë elektrike varet prej mundësive teknike, gjegjësisht prej nivelit të ujit në akumulim si dhe prej kërkesave të KEDS-it. Gjatë vitit të kaluar ka pas mundësi të gjenerimit më të madh për arsye se kërkesat për energji elektrike nga ana e KEDS-it kanë qenë më të mëdha.

Tabela 30: Performanca Financiare e NH "Ibër-Lepenc"

Indikatorët (000€)	Financiar	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat		3,808	4,093	3,974	4,184
Shpenzimet		(3,387)	(3,765)	(3,674)	(3,667)
Fitimi/Humbja operative		421	628	300	517
Zhvlërësimi dhe amortizimi		(4,591)	(4,598)	(4,677)	(4,624)
Borxhet e këqija		0	0	0	0
Fitimi/Humbja financiare		(4,170)	(3,900)	(4,376)	(4,107)
Paraja në fund të vitit		546	1,346	340	966
Asetet Fikse		137,973	134,602	130,939	130,852

Të hyrat e përgjithshme të ndërmarrjes për vitin 2014 janë realizuar në nivel më pak se sa kanë qenë në vitin paraprak apo 5% mbi planin. Por shiqur burimin e këtyre të hyrave, atëherë del se të hyrat nga energjia janë realizuar në nivel më të lartë se sa të hyrat nga uji i furnizuar dhe të hyrat nga ujitja që kryesisht ka rrjedhur nga gjendja e volitshme hidrologjike gjatë vitit që ka mundësuar gjenerimin e energjisë por edhe ruajtjen e nivelit të ujit në liqenin akumulues.

Të hyrat nga energjia elektrike, në këtë periudhë, kanë pjesëmarrje prej 60.38 % në të hyrat e gjithëmbarshme. Pjesëmarrja e të hyrave nga uji është 32.17 % , të ujitjes janë 4.60 % dhe të hyrat tjera 2.85 %.

Ndërsa shpenzimet operative për vitin 2014 janë përafërsisht të njëjta me ato të vitit 2013 me një rritje të lehtë prej 6% krahasuar me vitin e kaluar, në këtë rritje kanë ndikuar shpenzimet me rastin e furnizimit me ujë të Liqenit të Badovcit për nevojat e KRU "Prishtina" Sh.A.

Rrjedha e parasë (paraja e gatshme), gjatë viti 2014 ka pas një rënie në krahasim me vitin 2013 arsye për zvogëlimin e kesh-it sipas Menaxhmentit janë shpenzimet e krijuara në rastin e furnizimit me ujë të Liqenit të Badovcit për nevojat e KRU "Prishtina" Sh.A.

Kjo kompani në vitin 2014 ka pas një rënie të vlerës së aseteve në krahasim me vitin 2013 për 3,750 mijë euro. Kjo rënie e vlerës së aseteve ka ardhë si rezultat i zhvlërësimit (amortizimit) të mjeteve në vlerë prej: 4,624 mijë euro. Ndërsa kjo kompani për shkak të vlerës së aseteve, ka edhe shpenzime të mëdha të zhvlërësimit dhe përfundimisht del në humbje financiare.

4.13 Kompania Rajonale e Ujësjesit "HIDRODRINI",sh.a

Performanca Operative dhe Financiare

Tabela 31: Performanca Operative e KRU "Hidrodrini"

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Prodhimi i Ujit në (000)m3	26,981	28,438	30,600	29,783
Faturimi i Ujit (%)	34	28	34	30
Inkasimi i Ujit (%)	57	64	64	68
Uji i pafaturuar (%)	66	72	66	70
Testet e Dështuara të Ujit (%)	1	3	3	1
Konsumatorëve me Ujëmatës (%)	94	95	96	94
Numri i Konsumatorëve	30,745	34,945	40,000	40,730

Ndërsa proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës është 94 %, që në krahasim me vitin paraprak ka rënie për 1 % dhe shpjegohet si pasojë e inkorporimit të NJO Deçan.

Për vitin 2014 në nivel regional janë raportuar prodhim të ujit 29.7 mil m3 krahasuar me vitin 2013 kemi një rritje të prodhimit të ujit të pijes prej: 1.3 mil m3.

Nga tabela shihen treguesit progresivë në krahasim me vitin paraprak tek: faturimi i ujit, rënie e humbjeve të ujit dhe tek rritja e numrit të konsumatorëve. Ndërsa problemi më i madh qëndron të humbjet e ujit ku edhe pse në këtë vit ka pas një zbritje simbolike prej 2 % prap se prap përqindja e humbjeve të ujit në këtë kompani është mbi nivelin e sektorit në Kosovë.

Tabela 32: Performanca Financiare e KRU "Hidrodrini"

Indikatorët Financiar (000€)	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat	3,579	3,401	3,150	3,796
Shpenzimet	(1,634)	(2,043)	(1,964)	(2,132)
Fitimi/Humbja operative	1,945	1,358	1,186	1,665
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(1,178)	(1,368)	(1,964)	(1,413)
Borxhet e këqija	(780)	0	-	(250)
Fitimi/Humbja financiare	(13)	(10)	(778)	1.8
Paraja në fund të vitit	515	540	540	692
Asetet Fikse	18,473	22,723	-	22,136

Nga tabela vërehet se kompania ka të hyra pothuaj të njëjta si në vitin paraprak, përderisa ka rritje të kostove dhe zvogëlim të fitimit operativ, ndërsa si rrjedhojë e humbjeve të mëdha të zhvlerësimit viti mbyllet me humbje simbolike financiare.

Gëzon fakti se nga investimet e donatorëve dhe Qeverisë, ngritët vlera e aseteve për afro 4.0 milionë, por këtu një pjesë e rritjes rezulton edhe nga inkorporimi i aseteve të NJO të Deçanit, e cila në vitin 2013 ishte inkorporuar në kuadër të KRU "Hidrodrini"-Pejë.

4.14 Kompania Rajonale e Ujësjellësit "RADONIQI", sh.a

Performanca Operative dhe Financiare

Tabela 33: Performanca Operative e KRU "Radoniqi"

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Prodhimi i Ujit në (000)m3	15,073	14,777	14,408	13,527
Faturimi i Ujit (%)	41	48	49	50
Inkasimi i Ujit (%)	78	75	78	83
Uji i pafaturuar (%)	59	51	51	50
Testet e Dështuara të Ujit (%)	0	0	0	0
Konsumatorëve me Ujëmatës (%)	92	95	95	94
Numri i Konsumatorëve	28,703	29,869	30,889	30,957

Nga tabela e mësipërme në vitin 2014 vërehet kryesisht një prodhim më i ulët i ujit në krahasim me vitin paraprak për 1,250,000 m3 dhe në raport me planifikimet. Kjo rënie e prodhimit të ujit ka ardhë si pasojë e kërkesave gjithnjë e më të vogla të konsumatorëve për furnizim me ujë, sepse edhe me këtë sasi të prodhuar është përmbush obligimi për furnizim me ujë 24 orë në ditë.

Edhe tek faturimi kemi një rritje prej 2% në krahasim me vitin paraprak, kjo rritje prej 2 % është krijuar si pasojë e leximit të mirë të ujëmatësve, ndarjes së leximit nga arkëtimi, eliminimit të humbjeve teknike dhe lidhjeve ilegale. Vlen të përmendet shkalla e inkasimit e cila në vitin 2014 është rrit për 8% më shumë se në vitin 2013 apo mbi planifikimet për 5%, sikurse që është një tregues i suksesshëm që kemi edhe rritje të numrit të konsumatorëve.

Mbulushmëria e popullatës me furnizim me ujë të pijshëm në vitin 2014 është 97%.

Tabela 34: Performanca Operative e KUR "Radoniqi"

Indikatorët (000€)	Financiar	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat		3,233	3,751	3,615	3,655
Shpenzimet		(2,108)	(2,378)	(2,504)	(2,485)
Fitimi/Humbja operative		1,125	1,373	1,121	1,170
Zhvlerësimi dhe amortizimi		(1,683)	(1,772)	(1,773)	(1,609)
Borxhet e këqija		0	0	/	/
Fitimi/Humbja financiare		(558)	(399)	(652)	(439)
Paraja në fund të vitit		543	479	-	510
Asetet Fikse		28,697	29,548	28,604	29,111

Nga tabela vërehet se kemi një rënie të të hyrave prej afro 100 mijë euro, rritje të vogël të kostove operative dhe kjo rezulton një fitim operativ më të lartë nga plani apo më të vogël nga viti paraprak dhe kjo rezulton në fund një humbje financiare më të madhe prej afro 40 mijë euro apo më të vogël se planifikimi për 30%, sikurse që kishte ngritje të vlerës së aseteve të kompanisë nga investimet e reja të kompanisë me mbështetjen e buxhetit qeveritar dhe vetanak në raport me planifikimet nga plani i biznesit.

4.15 Kompania e Ujitjes "RADONIQI – DUKAGJIN", sh.a

Performanca Operative dhe Financiare

Tabela 35: Performanca Operative dhe Financiare

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Uji i Furnizuar (000m3)	40,949	29,805	35,074	24,416
Ujitja e Tokave Bujqësore (ha)	5,176	5,243	5,010	5,134
Faturimi (%)	100	100	100	100
Inkasimi (%)	53	56	56	58

Nga tabela e indikatorëve operativ vërehet një regres në rënien e Ha të tokës së ujitur për 109 Ha më pak se sa në vitin paraprak si rezultat i zvogëlimit të kërkesave nga bujqit, ndërsa shihet se ka zvogëlim të ujit të furnizuar për 5.3 milionë m3 më pak si rrjedhojë e të reshurave atmosferike dhe mosekzistimit të nevojës për ujitje.

Progres vërehet edhe në inkasimin e shërbimeve të ujitjes nga faturimi për 2% ndërsa pjesa e painkasuar është në rrugën gjyqësore të realizimit.

Tabela 36: Performanca Financiare e KU "Radoniqi - Dukagjini"

Indikatorët (000€)	Financiar	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat		891	690	707	742
Shpenzimet		(374)	(374)	(461)	416
Fitimi/Humbja operative		517	316	246	326
Zhvierësimi dhe amortizimi		(195)	(189)	(196)	(196)
Borxhet e këqija		(311)	(126)	(48)	(127)
Fitimi/Humbja financiare		11	1	2	3
Paraja në fund të vitit		140	125	-	111
Asetet Fikse		3,430	3,306	-	3,135

Nga tabela vërehet se viti 2014 financiarisht është më i frytshëm për kompaninë pasi ka të hyra për 52 mijë euro më shumë ani pse edhe kostot ishin më të larta.

Edhe përkundër zvogëlimit të të hyrave megjithatë Kompania në mënyrë simbolike përfundoi vitin me fitim operativ prej 326 mijë euro dhe fitim financiar simbolik prej vetëm 3.0 mijë euro. Rënia e vlerës së aseteve ishte rezultat i zhvierësimit ligjor sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

4.16 Kompania e Ujitjes "DRINI I BARDHË",sh.a

Indikatorët Operativ dhe Financiar

Tabela 37: Performanca Operative e KU "Drini i Bardhë"

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Uji i Furnizuar (000m3)	7,350	5,000	-	1,744
Ujitja e Tokave Bujqësore (ha)	2610	2,460	872	631,5
Faturimi (%)	100	100	100	100
Inkasimi i Ujit (%)	34	28	68	70

Nga tabela e indikatorëve operative vërehet se ka rënie të ujit të furnizuar nga shkakut se muaji Maj dhe Qershor ishte i varfër me kërkesa për ujitje ngase kishte të reshura të mjaftueshme ndërsa ka rënie të Ha të tokave bujqësore por që shumë nga to kanë përdorur vetëm ujitjen në një turne për përjashtim që në vitin 2013 kjo bëhej edhe në dy e tre turne.

Nga tabela vërehet se vetëm 70% bëhet inkasimi i ujit të faturuar dhe kjo nga mosgatishmëria e bujqëve për pagesë, përderisa kompania ka shumë lëndë të dërguara për realizim përmes gjykatës, të cilat kanë kosto të pagesës së taksave ndërsa realizimi i tyre pret me vite.

Tabela 38: Performanca Financiare e KU "Drini i Bardhë"

Indikatorët (000€)	Financiar	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat		303	309	117	313
Shpenzimet		(159)	(152)	167	149
Fitimi/Humbja operative		144	157	(50)	164
Zhvlerësimi dhe amortizimi		(178)	(145)	-	(151)
Borxhet e këqija		0	0	-	/
Fitimi/Humbja financiare		(34)	12	-	13
Paraja në fund të vitit		4	0.236	-	0.15
Asetet Fikse		3,257	3,436	-	3,364

Nga tabela e indikatorëve financiar kuptojmë se kemi të hyra të njëjta si në vitin 2012 kemi reduktim të shpenzimeve të zhvlerësimit dhe kjo e bie përfundimin financiar vjetor në fitim financiar simbolik prej 13 mijë euro nga humbja e vitit paraprak.

4.17 Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës, sh.a

Indikatorët Operativ dhe Financiar

Tabela 39: Performanca Operative e KMDK-së

Indikatorët Operativ	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Deponimi i Mbeturinave (ton)	195,729	207,633	196,724	224,524
Shkalla e Inkasimit (%)	84	84	100	88

Në vitin 2014 ka pasur ngritje të inkasimit në 8% në krahasim me vitin 2013 por ngecje të tij për 12 % nga planifikimet e planit të biznesit.

Të hyrat nga Inkasimi në vitin 2014 është 16% ma i lartë se në vitin 2013 si rezultat i arkëtimit të borxheve nga vitet e kaluara.

Në vitin 2014 janë grumbulluar rreth 17,000 ton më shumë mbeturina se sa në vitin 2013 apo 28,000 ton më shumë se planifikimet nga plani i biznesit, ndërsa shpenzimet e trajtimit të mbeturinave janë ulur nga 10.11€ në vitin 2013 në 9.64€ në vitin 2014, kjo ulje e shpenzimeve ka ardhur ngase mbeturinat janë trajtuar me makineri më të re që kanë pas shpenzime më të vogla.

Tabela 40: Performanca Financiare e KMDK-së

Indikatorët Financiar (000€)	2012	2013	Pl.Bizn. 2014	Realizuar 2014
Të hyrat	1,293	1,254	1,536	1,459
Shpenzimet	(936)	(1,162)	1,518	(1,317)
Fitimi/Humbja operative	357	92	18	142
Zhvlërësimi dhe amortizimi	(978)	(842)	(842)	(842)
Borxhet e këqija	0	0	0	0
Fitimi/Humbja financiare	(621)	(750)	(823)	(700)
Paraja në fund të vitit	20	14	40	43
Asetet Fikse	5,400	4,691	3,613	3,849

Siç shihet në tabelë, të hyrat më të mëdha se në vitin paraprak por larg nga caku i të hyrave nga plani i biznesit për 5%, po aq sa edhe rritje të shpenzimet operative, në krahasim me vitin paraprak 2013, gjë që ka sjellë deri në rezultatin përfundimtar – humbje financiare prej (700) mijë euro, apo një humbje më e vogël për 50 mijë se në vitin paraprak. Megjithëkëtë humbje financiare vjetore, kompania ka përmbyll vitin me fitim operativ simbolik që tregon se nuk vjen në pyetje vijimësia aktuale e veprimtarisë.

5. Përmbledhje dhe Rekomandime

Nga të gjitha të dhënat e pasqyruara në këtë raport të performancës së ndërmarrjeve publike të zhvilluara gjatë vitit 2013-2014 dhe duke i krahasuar me periudhën paraprake, mund të raportojmë një avancim të lehtë në performancë operative, gjithashtu edhe financiare të Ndërmarrjeve Publike Qendrore.

Ndër treguesit më të mirë të rezultateve të arritura të përmirësimit të performancës së shërbimeve publike, sipas sektorëve, është vazhdimi i gjenerimit dhe transmisionit në sektorin e energjisë. Po ashtu, përparim ka edhe tek performanca financiare me rritjen e fitimit financiar të KOSTT-it .

Progresi është evident edhe në sektorin e telekomunikacionit dhe furnizimit me ujë të pijshëm, duke rrit numrin e konsumatorëve në telefoni mobile për 3%, telefoni fikse për 4%, apo mbulueshmëria e popullatës me ujë të pijshëm është rrit për 2% nga 82% të vitit 2013 në 84 % në vitin 2014, rritja e numrit të konsumatorëve për furnizim me ujë të pijshëm për afro 20 mijë konsumatorë të rinj, humbje të ujit prej 57%, humbje kjo që është me e vogël se sa në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi e Bosnje.

Shikuar nga prizmi i menaxhimit të parasë publike dhe rregullsisë së proceseve financiare në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe bazuar në Opinionet e Auditorëve të Jashtëm, kemi një progres të matur në krahasim me vitin paraprak, ngase prej shtatëmbëdhjetë (17) pasqyrave financiare të audituara, me vlerësimin më të lartë si të pakualifikuara kishin tri NP. Pakualifikuara me theksim çështje: nëntë NP. Kualifikuara: një NP, kualifikuara me theksim çështje: tri NP dhe një NP kishte opinionin e auditorit me rezervë.

Performanca financiare e NP-ve në vitin 2014, po ashtu kishte progres, ngase nga shtatëmbëdhjetë (17) NP, dhjetë (10) nga to mbyllen vitin afarist me fitim financiar ndërsa shtete tjera edhe me tutje kishin humbje financiare, ani se tri nga to kanë humbjet më të vogla se vitin 2013.

Nëse shikojmë performacën e NP-ve, përmes trendëve të rritjes së vlerës së aseteve, ani pse vlera e aseteve merret nga librat kontabël dhe vlerësimi i fundit i bërë nga ish-AKM-ja, që nuk është shumë i kënaqshëm, vërejmë se nga raportet e Auditorëve të Jashtëm rezulton si vijon: Se gjashtë nga NP-të (KOSTT,PTK,IK,KRU Pr,KRU HRJ,KRU HM) kanë rritur vlerën e aseteve, duke falënderuar investimet në asete nga mjetet qeveritare, donatorëve, apo mjetet vetanake, katër nga to kanë nivelin e aseteve të njëjta me vitin 2013 dhe shtatë nga NP-të kanë zvogëluar vlerën e aseteve si rezultat i transformimeve të aseteve nga një NP në një NP tjetër me rastin e ndarjeve-shthurjeve, nga ristrukturimi i tyre siç është rasti me KEK-un pasi KEDS-i u privatizua, një NP, siç është Ibër-Lepenci, ka ulur vlerën e aseteve nga zhvlerësimi i tyre vjetor dhe të tjerat kryesisht kanë mbajtur gjendjen e vitit paraprak apo rënia ka ardhur edhe si rrjedhojë e investimeve më të vogla se sa zhvlerësimi që bëhet.

Natyrisht se krahas rritjes së nevojave për shërbime publike që rrjedhin nga proceset e rritjes së popullsisë dhe rritjes së zhvillimit ekonomik, kërkohet një progres edhe më i madh dhe ka vend për më shumë përparime në reduktimin e humbjeve të ujit të pijshëm, zvogëlimin e shpenzimeve të borxheve të këqija, rritjen e inkasimit nga shërbimet e kryera, dhe këto sigurisht se do të

ndodhin krahas konsolidimit të shtetit, funksionalizimit të gjykatave, investimeve në rrjet të ujësjellësit etj.

Funksionimi i Qeverisjes Korporative, edhe pse si koncept i ri në Kosovë, me Borde të Drejtorëve, të cilëve u është vazhduar mandati deri në përzgjedhjen e bordeve të reja, për të cilat borde të reja tri herë u hap konkursi nga të cilat dy herë u anulua ndërsa tani e një kohë konkursi i fundit nuk u finalizua me përzgjedhje të reja dhe kjo ka pas ndikim negativ në funksionimin e qeverisjes korporatave dhe në performancën e Ndërmarrjeve Publike. Tani shumë nga NP-të funksionojnë me borde jo të kompletuara, si pasojë e shkarkimeve dhe dorëheqjeve të Drejtorëve, dhe kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në vështirësitë në monitorimin e punës së tyre nga NJPMNP dhe ngecjet në komunikimet me Aksionarin, dhe kjo ka krijuar pa dëgjueshmëri të bordeve, mosgatishmëri për të lejuar mbikëqyrje të tyre nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, duke mos marrur parasysh komentet e saj, kërkesës për rishikim të vendimeve etj, gjithë një duke u thirrur në pavarësinë e përcaktuar me nenin 7.6 të ligjit mbi NP-të, nr. 03/L-087.

Ndryshim-plotësimi i ligjit mbi NP-të nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në gjysmën e vitit 2012 nuk ka mundur të përfshijë dinamikën e shpejtë të ndryshimeve të kërkuara me qëllim të një mirë-menaxhimi dhe një llogaridhënie më të lartë, sidomos të të autorizuarve të aksionarit-bordit, ndaj vetë Aksionarit, i cili ua ka besuar detyrat – fiduciare dhe ky ndryshim i ligjit mbi NP-të nuk ka përfshi të gjitha zbrazëtitrat dhe çështjet që kanë dal më vonë në funksionimin e NP-ve dhe problemet me mbikëqyrjen nga ana e Aksionarit.

Pas një shqyrtimi të Komisionit dhe Kuvendit të zbatimit të ligjit mbi NP-të, ishte rekomandim i Kuvendit të Kosovës se ligji mbi NP-të ka mangësi dhe rekomandohet që të bëhet amendamenti apo hartimi i një ligji të ri mbi NP-të. Ndryshimi i ligjit mbi Ndërmarrjet Publike i bërë në vitin 2014, ka adresuar pothuaj se vetëm çështjet e transformimit të një Ndërmerrje shoqërore apo një pjesë të saj por jo çështjet kryesore të qeverisjes korporatave, llogaridhënies, hierarkisë, autorizimeve nga aksionari dhe mbikëqyrjes efikase. Pikërisht për shkak të këtyre paqartësive të paraqitura në raportet mes menaxhmentit të lartë dhe Bordit të Drejtorëve të NP-ve, mandej një monitorimi më rigoroz nga Aksionari, përcaktimit më objektiv të kënaqësisë së konsumatorëve dhe përcaktimit të kriterëve mbi nivelin e efektshmërisë së punës së bordeve, në relacion me caqet e planifikuara, është e domosdoshme që qysh në vitin 2015, në kuadër të strategjisë legislative qeveritare të fillojë hartimi i një ligji të ri mbi NP-të.

Duke u bazuar në analizat e raportit mbi performancën e Ndërmarrjeve Publike që kanë qenë të mbështetura nga vlerësimet e rregullatorëve të shërbimeve, si dhe nga raportet e Auditorëve të Jashtëm, si dhe sfidave që paraqiten gjatë operimeve të NP-ve me qëllim të krijimit të shërbimeve publike, NJPMNP rekomandon këto masa që do të ndikonin në përmirësimin dhe avancimin e performancës së NP-ve:

- Avancimi i mëtejshëm i Qeverisjes Korporative në përputhje me parimet e OECD-së dhe ngritjes së përgjegjësisë për menaxhim me asete publike, përmes emërimit të Bordeve të reja të Drejtorëve profesionale dhe të pavarura dhe rritjes së llogaridhënies së bordit dhe menaxhmentit ndaj aksionarit;
- Plotësim –Ndryshimi i Ligjit mbi NP-të, gjegjësisht hartimit të një ligji të ri të NP-ve;

- Themelimi i një Instituti të Qeverisjes Korporative, i cili do të bënte kualifikimin e personave që do të shërbenin me pastaj në bordet e emëruara , si dhe do të trajnonte bordet në detyrë;
- Trajtimi me prioritet nga gjykatat kompetente të lëndëve nga Ndërmarrjet Publike mbi inkasimin e mjeteve për shërbimet publike;
- Investime edhe më tutje në rrjetin e vjetruar të ujësjellësve, me qëllim të zvogëlimit të humbjeve teknike të ujit- rrjedhjeve të ujit;
- Investime edhe më tutje në infrastrukturën hekurudhore, si përmbushje e standardeve evropiane dhe krijim i mundësive për investitorë të rinj – operatorë të rinj hekurudhorë;
- Funkcionalizimi i linjave ekzistuese hekurudhore deri tani jofunksionale si: Klinë- Prizren, Fushë Kosovë- Leposaviq dhe Fushë Kosovë –Merdare;
- Ngritja e komunikimit të NP-ve me institucionet lokale mbi rritjen e kualitetit të shërbimeve publike për qytetarët;
- Trajtimi nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale i rasteve sociale-konsumatorëve socialë të shërbimeve publike për ujë të pijshëm, grumbullim të mbeturinave, ngrohje qendrore dhe ujitje të tokave bujqësore;
- Rivlerësimi i përgjithshëm i aseteve të NP-ve nga autoritetet e licencuara për vlerësim asetesh, e financua nga Aksionari, si titullar i këtyre aseteve;
- Fuqizimi i rolit të Komisionit të Ministrave mbi NP-të, për vendimmarrje të fuqishme mbi mbrojtjen e interesave të Aksionarit;
- Mbështetja e plotësimin të kapaciteteve administrative e financiare të NJPMNP.